



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Marrëdhënie me Publikun”**

ofruar nga

**Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”,
Durrës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Anisa Subashi

2. Dr. Dorianë Pano

Shkurt 2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bachelor në “Marrëdhënie me Publikun” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë Univeristeti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD)
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Politike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Marrëdhënie me Publikun”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS nr. 371, datë 05.09.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMAS nr. 335, datë 04.07.2023*
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR nr. 103, datë 05.06.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike/6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	20 PAE/ 3 PAK v.a. 2020-2021 17 PAE/ 3 PAK v.a. 2021-2022 18 PAE/ 1 PAK v.a. 2022-2023
18	Numri i studentëve:	39 studentë v.a. 2020-2021 36 studentë v.a. 2021-2022 16 studentë v.a. 2022-2023
19	Komente / të tjera:	-

* Programi është riorganizuar me UMAS nr. 335, datë 04.07.2023 nga Bachelor në “Marrëdhënie me Publikun” në Bachelor në “Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun”. Programi i studimit po i nënshtrohet procesit të akreditimit për herë të parë vetëm për ata studentë që janë aktualisht të regjistruar dhe ndjekin studimet në këtë program studimi përpara riorganizimit, deri në diplomimin e tyre.




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Marrëdhënie me Publikun”, ofruar nga Departamenti i Shkencave Politike (DSHP), Fakulteti i Shkencave Politike Juridike (FSHPJ), Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD), është hapur për herë të parë me Urdhër MAS Nr. 371, datë 05.09.2013.

Programi i studimit është hartuar në përputhje me objektivat formuese përcaktuese, të përgjithshme apo specifike e duke mbajtur parasysh kërkesat për nivele cilësore bashkëkohore dhe në bashkëpunim me përfaqësues të tregut të punës dhe profesioneve në nivel kombëtar. Programi i studimit realizohet me 180 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Bachelor” në “Marrëdhënie me Publikun”.

Në këtë program studimi, zhvillimi dhe përcjellja e dijeve zhvillohet nëpërmjet një sërë disiplinash (formuese të përgjithshme, karakterizuese, integruese), me anë të së cilave synohet asimilimi i njohurive teorike dhe zhvillimi i mendimit kritik..

Programi është riorganizuar me UMAS nr. 335, datë 04.07.2023 nga Bachelor në “Marrëdhënie me Publikun” në Bachelor në “Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun”. Programi i studimit po i nënshtrohet procesit të akreditimit për herë të parë dhe nëse vlerësimi përfundimtar do të jetë pozitiv, do të jetë i vlefshëm vetëm për ata studentë që janë aktualisht të regjistruar dhe ndjekin studimet në këtë program studimi përpara riorganizimit, deri në diplomimin e tyre.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Ky raport i vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Bachelor në “Marrëdhënie me Publikun” është përgatitur nga Grupi i Ekspertëve të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) i cili përbëhet nga dy anëtarë: Prof. Asoc. Anisa SUBASHI dhe Dr. Dorianë PANO, me mbështetjen e Koordinatorës Teknike të ASCAL, Msc. Ersi Dako. Në punën për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ), grupi ka përvoja mësimdhënëse dhe aftësi analitike për të kryer një vlerësim të paanshëm, objektiv dhe racional të programit të studimit duke vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar.

Procesi i vlerësimit të jashtëm ka filluar me dorëzimin nga ana e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, (UAMD) të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) si dhe dosjes së vetëvlerësimit (DVV) me dokumentacionin mbështetës. Ekspertët u njohën me RVB dhe DVV nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik AMS të ASCAL.

Mbi bazën e një agjende të përcaktuar paraprakisht, në datat 8 dhe 9 Qershor 2023, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, Përgjegjësin e Departamentit të Shkencave Politike, me Grupin e vetëvlerësimit të programit, me Zyrën e Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë, me përfaqësues të Zyrës së Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit, me stafin akademik të programit të studimit, dhe me studentët e programit të studimit. Gjithashtu, GVJ zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Bibliotekë si dhe u njoh me mjediset e zhvillimit të procesit mësimor.

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion, apo dokumentave shtesë.

Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm u përcoll në Institucion përmes AMS më datë 22.01.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr. 19/10 Prot., datë 22.01.2024. Institucioni përcolli përgjigjen e tij përmes AMS më datë 06.02.2024 dhe me shkresë zyrtare me Nr. 169 Prot., datë 24.01.2024, përmes së cilës është shprehur se nuk ka komente. Për sa më lart, Draft-Raporti kthehet në Raport përfundimtar.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Marrëdhënie me Publikun”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (UAMD), veprimtarinë e tij e bazon në Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në aktet e tjera nënligjore mbi arsimin e lartë, të Statutit të Universitetit. (Evidencë 1 Statuti UAMD) . FSHPJ, pjesë e këtij institucioni, ofron programe studimi, të cilat reflektojnë interesat kombëtare. Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Marrëdhënie me Publikun” kontribuon në përgatitjen e specialistëve në fushën e marrëdhënieve me publikun dhe komunikimin, të cilët me kompetencat e tyre, do të punojnë për zhvillimin e modernizimin e vendit në hapësirat publike, sociale dhe ekonomike. Në qëllimet strategjike të UAMD përcaktohet ndër të tjera se ky program është në harmonizim të plotë me vlerat kulturore të kombit, duke ofruar kompetenca në sferën e marrëdhënieve me publikun, kjo në përputhje me etikën profesionale dhe qytetare, dhe në të njëjtën linjë me interesat kombëtare, duke mos dëmtuar në asnjë formë ato. (Evidencë 3,Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD-së 2020-2025)
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Në hartimin e programit të studimit Bachelor “Marrëdhënie me Publikun” synohet të formohen studentë me dije, aftësi dhe kompetenca profesionale, nëpërmjet mësimdhënies, aftësimit për përdorimin e arritjeve më të mira të teorisë, praktikës dhe shkencës, mbështetur dhe hartuar në përputhje me misionin e UAMD-së. Fusha e studimit në marrëdhënie me publikun, ka rëndësi të veçantë pasi formon profesionistë të aftë për të mbuluar fusha si media, marrëdhëniet me publikun, komunikimi, ekspert mediatik duke pasuruar më tej profilin e FSHPJ. (Evidencë 28, Neni 5, Draft-Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 1, Statuti i UAMD)
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.	UAMD, veprimtarinë e tij e bazon në Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në aktet e tjera nënligjore mbi arsimin e lartë, të Statutit të Universitetit (Evidencë 1) , Rregulloren bazë të tij (Evidencë 7) dhe akteve të tjera rregullatore të institucionit. Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Marrëdhënie me Publikun” kontribuon në

	<p>përgatitjen e specialistëve në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun, të cilët me kompetencat e tyre, do të punojnë për zhvillimin e modernizimin e vendit.</p> <p>(Evidencë 3_Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD-së 2020-2025).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Sipas të dhënave tabelore, në programin e studimit Bachelor “MP” në vitin akademik 2022-2023, janë angazhuar 18 PAE (3 Prof.As dhe 15 Dr.) dhe 1 PAK (Dr.). Gjithashtu, është angazhuar edhe 1 personel ndihmës-akademik. (Evidencë shtesë, personeli akademik i programit).</p> <p>Nisur nga të dhënat sa më lart dhe shqyrtimit të dosjes së stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, GVJ konstatoi se cilësia e stafit akademik efektiv dhe atij me kontratë të departamentit, garanton përvojën dhe kapacitetet e nevojshme për ofrimin e programit të studimit.</p> <p>DSHP ka të gjitha kapacitetet, qoftë si departament qoftë në ndërveprim me departamente të tjera të Universitetit, për të përballuar me sukses objektivat akademike që programi ofron.</p> <p>(Evidencë 17.1_Fusha e studimit për anëtarët e DSHP; Evidencë shtesë DVV_CV e personelit akademik të programit MP).</p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Marrëdhënie me Publikun” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe bazë, përgjegjëse për këtë program. Ky program studimi është hartuar sipas Legjislacionit në fuqi dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), dhe është i regjistruar si program i Ciklit të I-rë Bachelor, niveli 6 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë”. IAL ka paraqitur dhe propozimin e tij për kodifikimin e këtij programi studimi, i cili është në pritje të një unifikimi nga ana e ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p> <p>(Evidencë 1_Statuti UAMD; Evidencë 46_Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të programeve të studimit; Evidencë_23. Kodifikimi i programit të studimit)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie me Publikun” është hartuar dhe zbatuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e UAMD-së, aktet normative të tij si dhe aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi si dhe përshtatet më së miri me nevojat e tregut të punës për profesionistë në këtë fushë. Programi zbatohet në përputhje me Strategjinë e UAMD-së 2020-2025. Programi është në përputhje të plotë me ligjet në fuqi dhe legjislacionin zbatues, Kartën e Bolonjës dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe synon të ruajë dhe promovojë vlerat njerëzore, vlerat kulturore dhe interesat kombëtarë. DSHP ka të gjitha kapacitetet, qoftë si departament qoftë në ndërveprim me departamente të tjera të Universitetit, për të</i></p>

	<i>përballuar me sukses objektivat akademike që programi ofron. Cilësia e stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm të departamentit, garanton përvojën dhe kapacitetet e nevojshme për ofrimin e programit të studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht		Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Administrimi i programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie me publikun” realizohet nga DSHP, njësi bazë e FSHPJ, mbështetur në aktet rregullatore të njësive përgjegjëse të programit të studimit si dhe gjithë aktet ligjore e nënljgore në fuqi. (Evidencë 7_Rregullore UAMD; Evidencë 28_Draft-Rregullore e programit të studimit; Evidencë 8_Rregullore e FSHPJ). Angazhimi i personelit akademik nga fakultete të tjera të UAMD-së, si dhe angazhimi i personelit akademik me kontratë bazohet në marrjen e përgjegjësiwe respektive dhe vlerësimin e vazhdueshëm të punës së tyre. (Evidencë 26_Analizë e DSHP; Evidencë 45_Raport Vjetor i veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore dhe financiare; Takime në institucion me staf drejtues dhe personel akademik).
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Nga të dhënat e paraqitura në RVB dhe DVV, për realizimin e objektivave të programit të studimit, evidentohet se institucioni ka hartuar strategjinë e ndërkombëtarizimit në nivel institucional, ku lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe projekteve të cilat impaktojnë edhe këtë program studimi, zhvillohet në kuadër institucional. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh dhe organizata bashkëpunuese homologe vendase si Bashkia Durrës, Prefektura Durrës, Bashkia Tiranë, Autoriteti Portual Durrës, Njësitë Bashkiake, Kuvendi i Shqipërisë, Agjencia e Rinisë, etj. (Evidencë 53_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit).
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	UAMD ka marrëveshje specifike bashkëpunimi dhe të përgjithshme. Ato specifike lidhen me kapacitetet praktike dhe formuese të programit e përshijnë kryesisht insitucione publike, lokale e kombëtare (Bashkia Durrës, Autoriteti Portual etj). Ato të përgjithshme janë përgjithësisht të rrafshit akademik e mundësojnë ofrimin e aktiviteteve akademike në funksion të planit të studimit (Universitete të ndryshme në vend e rajon). Zhvillimi i praktikës

	<p>kryhet duke ju referuar rregullores përkatëse dhe përfundon me një raport të praktikës profesionale. <i>GVJ rekomandon të shtohen e përditëson marrëveshjet të cilat lidhen drejtpërdrejt me realizimin e objektivave të këtij programi studimi.</i></p> <p>(Evidencë 28, Neni 34_Draft Rregullore e programit të studimit; Evidencë 33_Rregullore e zhvillimit të praktikë s në FSHPJ; Evidencë 33.1_Formular aplikimi për praktikë n profesionale; Evidencë 53_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit).</p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Referuar Raportit Vjetor që njësia bazë harton në fund të viti akademik, por edhe nga diskutimet me staf dhe studentë të këtij programi studimi, rezulton se DSHP, ka hartuar një raport analitik të veprimtarive të departamentit për v.a 2021-2022 ku gjithashtu pohohet se për arsye të një marrëdhënie të ngushtë me punëdhënësit, zhvillimi i praktikave ka qenë i suksesshëm. <i>Megjithatë, nga GVJ nuk u gjet një analizë e mirëfilltë për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin që po shqyrtojmë, por një gjë e tillë mund të nënkuptohet nga bërja/zhvillimi i praktikave dhe materializimi i këtyre marrëveshjeve në praktikë sikurse raportohet.</i></p> <p>(Evidencë 47; 48_Analiza Vjetore e DSHP; Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Administrimi i programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie me publikun” realizohet nga DSHP, njësi bazë e FSHPJ, mbështetur në aktet rregullatore të njërive përgjegjëse të programit të studimit si dhe gjithë aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon prirjen drejt forcimit të bashkëpunimit mes IAL dhe institucioneve që ofrojnë vendet e punës që janë nën tipologjinë e diplomës përkatëse. Kjo do të ndikojë pozitivisht në forcimin e këtij programi studimi dhe nxjerrjen e brezave të kualifikuar në këtë drejtim. Në përputhje me ndryshimet dhe nevojat që paraqet tregu i punës, studentët duhet të jenë gjithmonë në gjendje që të bëjnë zgjedhjet më efektive për t’ju përshtatur sa më mirë këtij tregu. Suksesi do të kërkojë sigurisht një punë intensive dhe përpjekje jo të vogla, por që potencialisht ekziston mundësia e rritjes në vitet akademike në vazhdim.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie me publikun” është i organizuar në lëndë dhe module të cilat kanë nga 5-10 kredite ECTS të vlerësuara në përputhje me legjislacionin në fuqi (VKM Nr. 41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar). (Evidencë 29.1_Plani mësimor i programit të studimit). Programi i studimit është i organizuar në 6 semestra me module lëndësh, përfshi një pjesë të semestrit të dytë të vitit të 3-të, që i kushtohet përgatitjes së Detyrimit final (provim me shkrim ose mikro-tezës) si edhe kryerjes së praktikës profesionale në institucione publike ose private. Modulet e lëndës vlerësohen sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kjo ndarje ofron fleksibilitet në transferimin e krediteve dhe mobilitetin e studentëve, ndërsa punimi i diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar është i vlerësuar me 6 kredite. Totali i krediteve që studenti duhet të marrë për t’u diplomuar është 180 ECTS.</p> <p>(Evidence 28_Draft Rregullore e programit të studimit; Evidencë 29.1_Plani mësimor i programit të studimit).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Në termat e njohurive programi Bachelor në “Marrëdhënie me publikun” ofron të mundësojë zhvillim të aftësive dhe kompetencave në fushën e marrëdhënieve me publikun dhe komunikimit publik. Kurrikula e programit mundëson për studentët aftësi të ndryshme për një gamë të gjerë profesionale dhe specializimesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të programit të studimit. Programi synon të pajisë studentët me aftësitë e nevojshme që të përballojnë problemet bashkëkohore, tu mundësojë trajnim akademik dhe të promovojë profesionistët e së ardhmes për të mbuluar profesione si studiues i mediave, ekspert mediatik, gazetar, këshilltar politik etj. Programi ndërthur njohuritë e përgjithshme, të përcaktuara në Kategorinë A (të tilla si: Hyrje në Shkenca Politike, Hyrje në Ekonomi, Shkrim Akademik, Teoritë e Demokracisë, Kërkim në Shkenca Sociale etj), me njohuritë specifike të lidhura me fushën e studimit, të përcaktuara në Kategorinë B të tilla si: Teoritë e Komunikimit Masiv, Marrëdhënie me Publikun, Komunikim Politik, Raportim Lajmi dhe Studime, etj. Njohuritë teorike të përfituara nga kombinimi i lëndëve në Kategorinë A & B, së bashku me orët individuale të studimit dhe praktikën mësimore, ndikon në zhvillimin e njohurive dhe kompetencave për studentët e këtij programi, duke i bërë ata të aftë të</p>





	<p>kenë aftësitë e nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e marrëdhënieve me publikun.</p> <p>(Evidencë 29.1_Plani mësimor i programit të studimit).</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit i ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese, duke i grupuar lëndët/modulet sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse të shprehur në kredite ECTS.</p> <p>(Evidencë 29.1_Plani mësimor i programit të studimit bachelor ne MP).</p> <p>Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje. Lëndët mund të jenë semestrale ose vjetore Programi është i organizuar në tre vite akademike (180 ECTS), 6 semestra.</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Kategoria A, ka një ngarkesë prej 34 ECTS (18.89%) dhe ka të grupuara lëndë për përgatitje metodologjike dhe lëndë për kulturë të përgjithshme.</i> • <i>Në kategorinë B, e cila ka një ngarkesë prej 96 ECTS (53.34%), janë të grupuara lëndët për përgatitjen për disiplinën e marrëdhënieve me publikun</i> • <i>Kategoria C, me një ngarkesë prej 22 ECTS (12.22%), grupon lëndë ndërdisiplinore.</i> • <i>Kategoria D, me një ngarkesë prej 22 ECTS (12.22%), përfshin lëndët plotësuese.</i> • <i>Kategoria E përfshin detyrimin përmbyllës, provim formimi/Diplomë dhe ka një ngarkesë prej 6 ECTS (3.33%)</i>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi është i organizuar sipas Kategorive A-E, me përmbajtje sipas parashikimeve ligjore për natyrën e lëndëve në secilën kategori, sikurse dhe praktikën dhe detyrimet përmbyllëse (punim diplome/provim), të cilat i përkasin kategorive D dhe E (6 ECTS secila).</p> <p>(Evidencë 29.1_Plani mësimor i programit të studimit MP).</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>UAMD si një institucion i arsimit të lartë publik në RSH nuk ka një status të veçantë. Si i tillë ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi. (Evidencë 81_Ligji-80-2015_22.07.2015)</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në "Marrëdhënie me publikun" është në përputhje me profilin e programit Bachelor dhe i ngjashëm me programet ndërkombëtare. Ky program studimi është hartuar duke u bazuar në programe studimi të ngjajshme të ofruara</p>


	nga institucione ndërkombëtare, por edhe duke e përshtatur për një kohëzgjatje tre vjeçare. Për këtë kanë kontribuar edhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera. (Evidencë 53_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit)			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Në dokumentacionin e paraqitur në DVV dhe në takimin që u zhvillua në institucion me drejtuesin e njësisë kryesore dhe njësisë bazë na u sqarua se lidhur me kodifikimin e programit të studimit bachelor në "MP", janë në pritje të unifikimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, gjithsesi ata kanë hartuar një kodifikim të brendshëm të programeve të studimit e konkretisht për programin Bachelor në "MP" është përcaktuar kodi S63BA0414. (Evidencë 23_Kodifikimi i Programeve të studimit UAMD)			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Referuar dokumentacionit dhe RVB, rezulton se programi Bachelor në "Marrëdhënie me publikun" nuk ofrohet i përbashkët me një program tjetër të një IAL vendase apo të huaj.			
Konkluzione	<i>GVJ pas vlerësimit të të gjitha informacioneve, shprehet se programi i studimit Bachelor në "Marrëdhënie me Publikun" është plotësisht në përputhje me standardet dhe kriteret e kërkuara nga aktet ligjore të Republikës së Shqipërisë përse i përket organizimit të tij. Ky program studimi organizohet në module lëndësh të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe shuma mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë 1 v.a nga një student i cili ndjek një këtë program studimi është 60 ECTS. Programi i studimit Bachelor në "Marrëdhënie me publikun" është i organizuar në lëndë dhe module të cilat kanë nga 5-10 kredite ECTS të vlerësuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	FSHPJ si njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Marrëdhënie me publikun" ka në strukturën e tij 3 departamente: a) Departamenti i Shkencave Politike (DSHP); b) Departamenti i Administrimit Publike (DAP); c) Departamenti i Drejtësisë (DD). (Evidencë 16_Struktura Organizative UAMD) Programi i studimit Bachelor në "Marrëdhënie me publikun" ofrohet

	<p>nga Departamenti i Shkencave Politike, njësi bazë e FSHPJ. Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie me publikun” është hartuar në përputhje me politikat kombëtare siç janë parashikuar në Ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Ky program po ashtu është në përputhje me kriteret e paracaktuara në akte të tjerë ligjorë të aplikueshëm dhe të implementuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit si dhe nga vendimet e lëshuara nga institucionet kombëtare të akreditimit përfshirë Bordin e Akreditimit dhe ASCAL. (Akreditimi Institucional i UAMD). Organizimi dhe struktura akademike e njësisë kryesore dhe njësisë bazë është konform parashikimeve ligjore në fuqi dhe funksionojnë në bazë të akteve të brendshme rregullatore. Nga të dhënat e paraqitura nga IAL, përbërja e Departamentit në 3 vitet e fundit akademike paraqitet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viti akademik 20-21: 25 PAE, me kualifikimin 4 Prof.As., 20 Dr. dhe 1 Msc. dhe 4 PAK me kualifikimin 1 Prof.As., dhe 3 Dr. - Viti akademik 21-22: 20 PAE, me kualifikimin 1 Prof.Dr., 4 Prof.As., dhe 15 Dr., dhe 3 PAK me kualifikimin 1 Prof.As., dhe 2 Dr. - Viti akademik 22-23: 21 PAE, me kualifikimin 1 Prof.Dr., 5 Prof.As., dhe 15 Dr., dhe 1 PAK me kualifikimin Dr. <p>(Evidencë 1_Statuti i UAMD; Evidencë 7_Rregullore UAMD; Evidencë 28_Draft Rregullore e programit të studimit; Evidencë 17_Stafi akademik në DSHP; Evidencë shtesë, personeli akademik i Departamentit dhe CV e stafit akademik për programin MP).</p> <p>DSHP si njësi bazë, në bashkëpunim edhe me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), kryejnë vlerësimin e brendshëm periodik për rezultatet dhe nivelin cilësor të aktiviteteve formuese, sipas modaliteteve të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore (Evidencë 1, Neni 77,78_Statuti UAMD; Evidencë 10_Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm për sigurimin e cilësisë në UAMD; Evidencë 11_Urdhër për ngritjen e NJSC në FSHPJ). Lidhur me procesin e vlerësimit të jashtëm, institucioni i është nënshtruar procesit periodik të vlerësimit të jashtëm, akreditimit, ndërsa programi i studimit po i nënshtrohet për herë të parë këtij procesi, për studentët të cilët janë regjistruar dhe ndjekin studimet në këtë program studimi, deri në diplomimin e tyre, duke qenë se programi është riorganizuar.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislationin në fuqi, duke angazhuar</p>	<p>Institucioni angazhon personel akademik, personel ndihmës akademik me karakter mësimor, që ndihmon në realizimin e veprimtarisë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe personel me karakter</p>

<p>personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>administrativ, që ndihmon në realizimin e veprimtarive të mësimdhënies. Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie me publikun” ka personel akademik dhe administrativ të kualifikuar që është i përkushtuar për të ofruar të gjithë mbështetjen në mënyrë që objektivat e programit të studimit të përmbushen. Në këtë kontekst personeli akademik dhe ai ndihmës njihen me detyrat dhe të drejtat nëpërmjet kontratës së punës. FSHPJ, ku bën pjesë DSHP, ka në përbërjen e saj një personel akademik ndihmës, i cili mbështet këtë njësi në realizimin e proceseve akademike dhe administrative. Njësia kryesore angazhon resurset e brendshme për monitorimin e praktikave mësimore. UAMD siguron punësimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm për mirëmbajtjen dhe realizimin e orëve laboratorike dhe të mjediseve të tjera mësimore referuar rregullores së institucionit dhe strukturës organizative të tij.</p> <p>(Evidenca 16 _Struktura Organizative e UAMD)</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Çdo program studimi në UAMD sikurse dhe programi Bachelor në “Marrëdhënie me publikun” ka një koordinator. Departamenti ka caktuar si koordinatorë (Dr. L.L) për programin Bachelor në “MP” (Evidencë 76_Vendim për emërimin e Koordinatorit të Programit të Studimit). Koordinatori i programit të studimit mbështet planifikimin, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e programit të studimit, për të siguruar përmbushjen e misionit dhe objektiveve të programit. Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të tij, janë të parashikuara në aktet e brendshme rregullatore.</p> <p>Ndër detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Koordinatorit të Programit, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • mbikëqyr respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën e caktuar • harton strategjinë e zhvillimit të programit të studimit SHP • propozon ndryshime në planin mësimor të cilat më pas i paraqet për diskutim në Asamblenë e personelit akademik të njësisë bazë • ruan komunikimin e vazhdueshëm me studentët e këtij programi studimi dhe përcjell çdo problematikë të tyre në autoritetet drejtuese të FSHPJ dhe DSHP • organizon analizën vjetore të programit të studimit • raporton tek përgjegjësi i departamentit për mbarëvajtjen dhe problematikën e hasura në lidhje me programin Marrëdhënie me Publikun <p>(Evidencë 28 neni 8_Draft Rregullore e programit të studimit MP-Detyrat e organeve drejtuese-Përshkrimi i detyrave të Koordinatorit të Programit të Studimit).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren një impenjim serioz dhe transparent për të ndërtuar një sistem të përzgjedhjes dhe angazhimit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ mbi bazën e korrektësisë, transparencës, meritokracisë dhe cilësisë së zhvillimit të programit të</i></p>

	<p>studimit. Për këtë program studimi, departamenti zotëron një personel akademik dhe administrativ të kualifikuar. Anëtarët e personelit akademik kanë eksperiencën e nevojshme akademike dhe janë autorë të disa botimeve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, në fushat përkatëse me interes për to. Në përmbushjen e objektivave të studimit të ciklit të parë shihet një angazhim maksimal i burimeve njerëzore, por edhe një shfrytëzim optimal i burimeve të ndryshme të informacionit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjell nga institucioni, konfirmuar edhe gjatë vizitës dhe takimeve të zhvilluara në institucion, konstatohet se njësia kryesore dhe ajo bazë përgjegjëse për këtë program studimi, disponojnë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie me publikun”. Drejtuesi i Departamentit, në bashkëpunim me Dekanin, dhe personelin efektiv të njësisë bazë grumbullojnë dhe analizojnë informacionin e plotë mbi programin. Informacioni gjendet gjithashtu edhe në faqen zyrtare të UAMD, faqeve sociale të fakultetit, broshurave dhe katalogut studentor si edhe gjatë shpërndarjes dhe shpjegimit të syllabuseve.</p> <p>(Evidencë 1_Statuti i UAMD; Evidencë 7_Rregullore e UAMD; Evidencë 28_Draft Rregullore e Programit MP; Evidencë 46_RVB në FSHPJ; Evidencë 47,48_Analizë vjetore e punës së DSHP; Evidencë 22_Urdhër për hapjen e programit të studimit; Evidencë 29_Vendim Senati për riorganizimin e programit MP)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>DSHPJ, njësi bazë në FSHPJ, që ofron programin e studimit, disponon informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij programi studimi, në përputhje me statutin dhe rregulloren e Universitetit, rregulloren e fakultetit dhe të departamentit. Secili aktivitet është vlerësuar në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit është 3 vjeçar, i organizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me 180 kredite (ECTS). Viti akademik i programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie me Publikun” përmban 6 semestra të rregullt mësimor me kohëzgjatje 15 javë mësimore. Në planin mësimor (Evidencë ASCAL, Tab 9,10) të programit të studimit, si dhe në syllabuset e lëndëve, jepet ngarkesa e studentëve në auditor dhe orët jashtë</p>

	<p>auditorit për çdo aktivitet formues. (Evidencë 31_Syllabuset e lëndëve). Programi i studimit” përmban 29 lëndë, prej të cilave 23 me detyrim dhe 6 lëndë me zgjedhje (4 lëndë vjetore dhe 25 semestrare) i organizuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 6 lëndë bazë (Kategoria A – 34 ECTS – 18.89%), - 16 lëndë karakterizuese (Kategoria B – 96 ECTS – 53.34%), - 4 lëndë ndërdisiplinore (Kategoria C – 22 ECTS – 12.22%), - 2 lëndë plotësuese - (Kategoria D – 22 ECTS – 12.22 %) - 1 detyrime përmbyllëse - Kategoria E – 6 ECTS – 3.33%.
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Informacioni i nevojshëm që lidhet me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, është i përcaktuar në aktet e brendshme rregullatore. Njohja dhe transferimi i kredive miratohet nga një komision ad-hoc i ngritur nga njësia bazë. (Evidencë 7_Rregullore e UAMD, Neni 44, Pranimi në Programet e ciklit të parë të studimeve dhe planifikimi i kuotave; Evidencë 28 Neni 10, 11_Draft Rregullore e Programit të Studimit). Për vetë natyrën e fushës së programit të studimit, fusha e marrëdhënieve me publikun, kriteret e pranimit janë vetëm ato të përgjithshme dhe nuk ka kriteret specifike. (Evidencë 27_Vendim Senati për miratimin e kuotave të pranimit; Evidencë 25_Vendim Senati për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve). Kandidati që dëshiron të ndjekë programin e studimit Bachelor në “Marrëdhënie me publikun” duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të ketë përfunduar me sukses maturën shtetërore dhe të zotërojë Dëftesën e Pjekurisë; • të ketë dhënë provimet e Maturës Shtetërore • të përmbushë kriterin e mesatares.
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Plani mësimor i detajuar është pjesë integrale e Rregullores së Programit të studimit. Në planin mësimor (syllabuset) pasqyrohen këto elementë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimi i lëndës/modulit; • Viti/semestri kur zhvillohet lënda; • Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën; • Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit; • Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës;
	<ul style="list-style-type: none"> • Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë; • Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik; • Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS;

	<ul style="list-style-type: none"> • Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre; • Format e vlerësimit të studentëve; • Detyrimet e studentit për lëndën; • Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse. <p>(Evidencë 28_Draft Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 31_Syllabuset e lëndëve MP).</p> <p>Programi i studimit ka në total 23 lëndë/module të detyrueshme, 6 grup lëndësh me zgjedhje, praktikën dhe detyrimin përmbyllës (punim diplome/provim), të ndara në kategori A-E. Ngarkesa totale e programit të studimit është 180 ECTS (4500 orë në total, prej të cilave 1485 orë në auditor/ 3015 orë studim individual/ prej të cilave 45 orë praktikë), me një shpërndarje prej 60 ECTS/1500 orë, në secilin vit akademik.</p> <p>Në vitin e I-rë, programi ka të parashikuar 495 orë në auditor/1005 orë studim individual. Në vitin e II-të ky raport është 540 orë në auditor/985 orë studim individual. Në vitin e III-të, janë të parashikuara 450 orë në auditor/1025 orën studim individual/ 45 orë praktikë.</p> <p>Në planin mësimor detajohen orët për leksionet/seminaret/ ushtrimet/ laboratorët/detyrat, si në auditor ashtu edhe orët e studimit individual. Frekuentimi është i detyrueshëm për të gjitha lëndët mësimore dhe praktikën mësimore në masën 75%. Mungesa në seminare dhe praktikë është e pranuar deri në masën 25% .</p> <p>(Evidencë 29.1_Plani mësimor i programit të studimit; Evidencë 28_Draft Rregullore e Programit të Studimit).</p> <p>Vlerësimi në një lëndët bëhet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Provimi i ndërmjetëm (40%); 2. Provimi përfundimtar (50%); 3. Projektet / detyrat e kursit (10%). <p>Në syllabuset e lëndëve janë të përcaktuara format e vlerësimit të vazhdueshëm dhe pesha specifike në përqindje e secilit prej komponentëve të vlerësimit (Evidencë 31_Syllabuset e lëndëve MP).</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Përmirësimi dhe përditësimi i programit të studimit është një proces i cili evidentohet dhe i takon personelit akademik të këtij programi studimi, të cilët në liri të plotë akademike propozimet e të cilëve më pas propozohen dhe miratohen në departament përpara fillimit të vitit akademik. Këto ndryshime lidhen si me përditësimin e syllabuseve ashtu edhe me përditësimin e programit të studimit në tërësi. Propozimi përcillet në Dekanat.</p>

	(Evidencë 31_Syllabuset e lëndëve MP).			
Konkluzione	<i>Programi Bachelor në “Marrëdhënie me Publikun” siguron një informacion efikas për studentët në lidhje me programin e studimit, dhe u ofron atyre të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programit të studimit, lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër, ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën mësimore etj. Informacioni në fjalë jepet në format të lehtë dhe të kuptueshëm, si dhe lehtësisht të aksesueshëm, si me shkrim, ashtu edhe në formë elektronike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p> <p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Emërtimi i programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie me publikun” vlerësohet si i përshtatshëm në funksion të përmbajtjes, objektivave formuese, por edhe mundësive të punësimit apo vijimit të studimeve në ciklet pasardhëse. Kombinimi i komponentëve teorik me ato praktik, vlerësohet i përshtatshëm, duke qenë se në semestrat e parë studentët pajisen me njohuri të formimit të përgjithshëm dhe karakterizues të disiplinës përkatëse, për të vijuar në vitin e tretë me praktikën dhe punimin e diplomës.</p> <p>(Evidencë 29.1_Plani mësimor i programit të studimit).</p> <p>Shpërndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese në: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, integruese dhe plotësuese, ndihmon studentët të fitojnë njohuri, të përmirësojnë aftësitë dhe të rrisin mundësitë e punësimit të tyre.</p> <p>Vlerësohet se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit mundëson arritjen e objektivave të përgjithshme dhe objektivave specifike të programit të ciklit të parë, të përcaktuara edhe në aktet e brendshme rregullatore duke bërë të mundur në këtë mënyrë që në përfundim të studimeve studentët të jenë profesionistë të aftë për të realizuar analiza politike, të zotërojnë koncepte, dije dhe njohuri të plota mbi teorinë e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun dhe të jenë të aftë ta orientojnë karrierën e tyre në shërbim të interesave më të larta dhe të parimeve demokratike të shoqërisë.</p> <p>(Evidencë 28_Draft Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 47,48_Analiza e DSHP)</p>

<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, lëndët dhe ngarkesa e tyre, është në përputhje me një program studimi të ciklit të parë në fushën e marrëdhnieve publike dhe përmban lëndë të përgjithshme dhe karakterizuese të përafërt me programe të ngjashme (kryesisht lëndët teorike).</p> <p>(Evidencë 29.1_Plani mësimor i programit të studimit).</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit ju ofron studentëve mundësinë të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, të komunikojnë qartë, të kuptojnë dimensionet etike të vendimeve që ata bëjnë, të njohin rolin dhe rëndësinë e marrëdhënieve dhe menaxhimit efektiv në përmirësimin e shoqërisë dhe anëtarëve të saj. Veprimtaritë formuese përmes trajtimeve teorike, praktike, seminareve apo aktivitete të tjera, lehtësojnë arritjen e objektivave mësimore, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin në fund të programit të studimit. DSHP ka arritur të ketë një program të ndërtuar sipas kërkesave të “Sistemit të Bolonjës” i cili krijon kushtet për të marrë pjesë në një nga objektivat e kësaj marrëveshje që është pikërisht Sistemi European i transferimit të Krediteve (European Credit Transfer System–ECTS), duke krijuar mundësinë që kreditet të transferohen nga universitetet e vendit në universitetet e tjera brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>(Evidencë 34.1_ Studimi i tregut të punës për studentët e diplomuar të këtij programi; Evidencë 28_Draft Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 29.1_Plani mësimor i programit të studimit).</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Përditësimi i programeve të lëndëve/moduleve, si një ndër komponentët e përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit është një proces periodik i cili inicohet kryesisht nga titullarët e lëndëve. <i>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve dhe referuar evidencave mbi fondin e bibliotekës rezulton se nuk ka mjaftueshëm literaturë fizike në gjuhën shqipe dhe në atë angleze (tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, libra apo revista shkencore të nevojshme) të përshtatshme me nevojat e programit të studimit, element i cili u diskutua edhe gjatë takimeve të zhvilluara në institucion.</i> Argumenti kryesor i dhënë nga stafi akademik lidhet me mungesën e teksteve të viteve të fundit, të përkthyer në gjuhën shqipe, mangësi e cila tejkalohet nëpërmjet materialeve narrative të përgatitura nga ana e personelit akademik dhe që i vihen në dispozicion studentëve. <i>GVJ rekomandon të shihet me prioritet shtimi i numrit të titujve specifik të fushës së marrëdhënieve me publikun në bibliotekën e universitetit.</i></p> <p>(Evidencë 31_Syllabuset e lëndëve; Evidencë shtesë_Lista e titujve në bibliotekë për programin bachelor MP; Takimi me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit).</p>

<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësi dhe kompetencave të synuara.</p> <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nisur nga përmbajtja e programit të studimit, rezulton se qëllimi i kurrikulës në këtë program studimi është t'u ofrojë studentëve njohuri të cilat do të jenë të nevojshme edhe për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit dhe në të njëjtën kohë t'u përgjigjet kërkesave me të cilat do të përballen studentët gjatë realizimit të tyre profesional dhe shkencor. Lëndët e këtij programi studimi i pajisin studentët jo vetëm me njohuri të përgjithshme, por edhe me njohuri të specializuara në disiplinën e marrëdhënieve dhe komunikimit me publikun. Nga një pikëpamje utilitariste punësimi i studentit është shkaku final i procesit të studimeve të larta dhe arsyeja kryesore e ekzistencës së tyre. <i>GVJ rekomandon që së pari duhet të shihen mundësitë e drejtpërdrejta të punësimit pas diplomimit në këtë nivel bachelor, por nuk duhen lënë pa konsideruar mundësitë e punësimit që vijnë si pasojë e vazhdimit të studimeve master, atyre profesional dhe shkencor, që vijnë si pasojë e diplomimit në këtë program bachelor.</i></p> <p>(Evidencë 28_ Draft Rregullore e programit MP; Evidencë 5_Plani i veprimit strategjik të DSHP; Evidencë 34.1_ Studimi i tregut të punës)</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>DSHP tregon një impenjm të mirë në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm dhe konsolidimit të programit të studimit, përmes ndarjes mes formimit teorik dhe atij praktik.</i></p> <p><i>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve dhe referuar evidencave mbi fondin e bibliotekës rezulton se nuk ka mjaftueshëm literaturë fizike në gjuhën shqipe dhe në atë angleze (tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, libra apo revista shkencore të nevojshme) të përshtatshme me nevojat e programit të studimit, ndaj IAL duhet të shohë me prioritet shtimin e numrit të titujve specifik të fushës së marrëdhënieve me publikun në bibliotekën e universitetit.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="635 1379 842 1440">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="842 1379 1050 1440">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1050 1379 1257 1440">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1257 1379 1471 1440">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							


Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------




<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Statet e zhvillimeve politike, sociale dhe ekonomike, zhvillimi institucional dhe integrimi evropian në vendin tonë, gjithmonë e më tepër kërkojnë krijimin, përgatitjen dhe konsolidimin e një tradite të re në mjedisin shqiptar sa i përket marrëdhënieve dhe komunikimit me publikun. Për t’ju përgjigjur këtyre kërkesave, programi i studimit është hartuar në mënyrë të tillë që të krijojë specialistë të aftë për të kryer një ekspertizë në mjedisin shqiptar. Si nga dokumentacioni i administruar, ashtu edhe nga takimet e zhvilluara në institucion me drejtues të njëjste kryesore\bazë si edhe me përfaqësuesit e GVB, deklarohet se në funksion të përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit dhe përshtatjes me kërkesat e tregut të punës, departamenti ka hartuar “Analizën e tregut të punës”, e cila merr në konsideratë propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>(Evidencë 34.1_Analiza e tregut të punës; Evidencë 5_Plani i zhvillimit strategjik të DSHP).</p> <p>Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të programit të studimit është e parashikuar në aktet e brendshme rregullatore. Përfshirja realizohet si nga vlerësimet që studentët bëjnë nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve për vlerësimin e programit dhe procesit në tërësi, ashtu edhe nëpërmjet zhvillimit të takimeve me ta apo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në organet kolegjiale të institucionit.</p> <p>(Evidencë 44,45 _Raporte vetëvlerësimi dhe vlerësimi të studentëve për programin). Kontakti me studentët dhe me përfaqësues të tjerë nga tregu i punës, mbahet kryesisht edhe nga koordinatori i programit të studimit.</p> <p>(Evidencë 28_Draft Rregullore e programit të studimit MP-Neni 8, pika 2 Përshkrimi i detyrave të Koordinatorit të Programit të Studimit).</p> <p>Përfshirja e studentëve në këtë proces zhvillohet si gjatë kohës që studentët ndjekin programin e studimit, ashtu edhe pas diplomimit të tyre. (Evidencë 7_Rregullore UAMD Neni 121, pika 6 gërma b thuhet: “Të shprehin mendime dhe propozime për programet e studimeve të UAMD-së, rregulloret për veprimtaritë mësimore, si dhe të drejtën për të studiuar).</p> <p>Institucioni përmes strukturave të tij, mban lidhje me studentët e diplomuar, të cilët kontaktohen vazhdimisht përmes formave të ndryshme të komunikimit, duke marrë prej tyre propozime të mundshme në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Ky është një element pozitiv, duke qenë se studentët Alumni njohin si programin e studimit, ashtu edhe kërkesat dhe pritshmëritë e tregut të punës për studentë të diplomuar në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat</p>	<p>(Evidencë 79.1_Udhëzues-Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës)</p> <p>GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimeve me drejtues të njësisë bazë dhe personel akademik të këtij programi studimi,</p>

programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	konstatoi se procesi i konsultimit dhe kontakti me grupet e interesit, qofshin publike apo private, duke marrë në konsideratë nevojat specifike lokale, apo dhe më gjerë, të cilat u vijnë në ndihmë të studentëve për të qënë më afër standarteve akademike dhe kërkesave të tregut të punës realizohet në aktivitete, forume e ëorkshop-e akademike të organizuara nga institucioni. (Evidencë 78_Forumet, Seminaret, Workshop-e akademike të organizuara në UAMD)			
Konkluzione	<i>DSHP, si njësi përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Marrëdhënie me Publikun" ka qënë në koherencë dhe në përmbushje të ndryshimeve të kuadrit ligjor duke përshtatur programet e tij të studimit. Angazhimi dhe përfshirja e studentëve si dhe partnerëve apo organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit është i përmbushur.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format kryesore të mësimdhënies janë leksione/seminare/orë të organizuara leksione/seminare, ushtrime/detyra kursi apo projekte, të organizuara në module si dhe konsultime individuale dhe ose në grup. Numri total i veprimtarive formuese është 29, të parashikuara 27 provime, praktika mësimore dhe detyrime përmbyllëse (Diplomimi). (Evidencë 29.1, Plani mësimor i programit MP)
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Gjatë vizitës në institucion dhe diskutimeve me përfaqësues të ndryshëm me Drejtuesin e Departamentit, anëtarët e GVB, personelin akademik dhe studentët, u konstatua se personeli akademik përdor shumëllojshmëri metodash didaktike, përfshi përdorimin e teknologjisë së informacionit, me qëllim, qoftë lehtësimin e mësimdhënies, qoftë përmirësimin e kompetencave të studentëve në përdorimin e teknologjisë. Gjatë orëve të seminarit, një synim i rëndësishëm i stafit akademik është nxitja e të menduarit kritik dhe


	<p>gjykimit të studentëve, çka arrihet nëpërmjet diskutimeve dhe analizës së rasteve konkrete të lidhura me temën përkatëse. Duke qenë se fusha e programit të studimit, marrëdhënie me publikun ka një natyrë kryesisht teorike, format klasike të mësimdhënies janë mbizotëruese, të cilat adoptohen edhe në bazë të nevojave të studentëve.</p> <p>(Evidencë 28_Draft Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 31_Syllabuset e lëndëve).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Bazuar edhe në aktet e brendshme rregullatore mbi aspektet didaktike, institucioni mbështet stafin akademik të përcaktojë në mënyrë autonome metodat pedagogjike, në funksion të përmbushjes së qëllimit dhe objektivave të programit të studimit në tërësi, por edhe lëndëve apo moduleve të veçanta, si pjesë përbërëse të kurrikulës.</p> <p>(Evidencë 28_Draft Rregullore e Programit të Studimit).</p> <p>Zhvillimi profesional i personelit akademik, ku përfshihet edhe përmirësimi i kompetencave didaktike, është në fokusin e institucionit. Këto elementë konstatohen si nga takimet e zhvilluara në institucion ashtu edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë në kuadër të akreditimit të këtij programi studimit.</p> <p>(Evidencë 3_Plani i zhvillimit strategjik UAMD).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit të përcjellë nga institucioni, dhe nga takimet me pedagogët e angazhuar në këtë program studimi si dhe me studentët, GVJ konstaton se ka një angazhim të personelit akademik për të përshtatur format e mësimdhënies me natyrën e lëndës së zhvilluar. Personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, sipas tematikave dhe profilit të lëndëve ku ata janë të angazhuar, si titullar apo si asistentë.</p> <p>(Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit; Evidencë shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve; Evidencë 3.6_Rregullore e Programit të Studimit)</p> <p>Në Rregulloren e UAMD, janë parashikuar të gjitha modalitetet që sigurojnë zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Instituconet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” për rekrutimin dhe punësimin e personelit akademik me nivelin e duhur të kualifikimit akademik dhe fushën kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Rishikimi i programeve të lëndëve si në aspektin përmbajtësor, ashtu edhe metodat e mësimdhënies, duke marrë në konsideratë edhe kërkesat e studentëve dëshmon për përmbushjen e këtij kriteri nga ana e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit në proces akreditimi. Ky vlerësim realizohet nga studentët për pedagogët dy herë në vit në fund të çdo semestri.</p> <p>(Evidencë 45_Formular vlerësimi për pedagogët nga studentët; Evidencë 46_RVB në FSHPJ)</p>

<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Struktura e UAMD-së ka të ndërlidhura të gjitha njësitë përbërëse të strukturës në funksion të mësimdhënies dhe të koordinimit të aktiviteteve, si edhe departamentet si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive</p> <p>Në Statutin e UAMD <i>specifikohet se departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. (Evidencë 1, Neni 10).</i></p> <p>Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron. Një tjetër njësi që promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies është edhe Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ai vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit në fuqi. Kjo zyrë bashkëpunon me njësitë kryesore dhe bazë dhe realizon një sërë aktivitete të parashikuara në planin e saj të veprimit, në funksion të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Gjatë takimeve në institucion, përfaqësuesit deklaruan se buxheti financiar në nivel institucioni bëhet çdo vit. Raportet financiare hartohen në bazë institucioni dhe janë të ndara sipas cikleve dhe programeve të studimit. Planifikimi i financimit realizohet në mënyrë paraprake për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit.</p> <p>(Evidenca Nr. 47 Analiza e DSHP 2021-2022)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Metodat e mësimdhënies janë një ndërthurje e metodës klasike të shpjegimit me projektme të materialeve mësimore të përgatitura nga pedagogët e lëndëve. Personeli akademik dhe procesi mësimor janë në vlerësim periodik nga ana e studentëve përmes pyetësorëve dhe nga Nj.S.B.C. Studentët shprehin mendimet dhe kërkesat e tyre edhe përmes përfaqësuesve në Këshillin Studentor. Kryetari i Këshillit Studentor është pjesë e Senatit Akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.


<p>Kriteret</p>	<p style="text-align: center;">Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive janë të përcaktuara në</p>



<p>testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>aktet e brendshme rregullatore, sikurse dhe në syllabusin e secilës lëndë të cilat i vihen në dispozicion studentëve në fillim të çdo semestri. Në syllabuset e lëndëve janë të përcaktuara format e vlerësimit të vazhdueshëm dhe pesha specifike në përqindje e secilit prej komponentëve të vlerësimit. (Evidencë 28_Draft Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 31_Syllabuset e lëndëve)</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët njihen me këta elementë që lidhen me programin e studimit që në kontaktin e parë me pedagogët, të cilët u prezantojnë syllabusin dhe mënyrën e vlerësimit (Takim me studentët). Komunikimi dhe përcjellja e informacionit tek studentët mundë sohet edhe në përmjet platformë s PITAGORA. (Evidenca 72_Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH)) Në syllabuset e lëndëve (Evidencë 31_Syllabuset e lëndëve), të cilat i vihen në dispozicion studentëve në fillim të çdo semestri, janë të përcaktuara format e kontrollit të dijeve, të cilat janë në përputhje me aktet e brendshme rregullatore. (Evidencë 28_Draft Rregullore e Programit të Studimit). Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • me provim me shkrim; • me detyra kursi, projekte • i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi.
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se format e kontrollit të dijeve janë të ndryshme dhe përfshijnë: pjesëmarrjen aktive në seminare, dorëzimi i detyrave/projekteve, provim i ndërmjetëm dhe provimi përfundimtar. Komponentët kryesorë të vlerësimit, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Provimi i ndërmjetëm (40%) • Provimi përfundimtar (50%) • Projektet / detyrat e kursit (10%) <p>Vlerësimi bazuar në pikët e përfuara është:</p> <p>nota 4: 0 – 504 pikë; nota 5: 505-574 pikë; nota 6: 575-664 pikë; nota 7: 665-754 pikë; nota 8: 755-844 pikë; nota 9: 845-934 pikë; nota 10: 935-1000 pikë</p>
<p>Kriteri 4. Njëسيا bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë</p>	<p>UAMD, ka zgjedhur si indikator shumë të rëndësishëm për të siguruar përfshirjen e studentëve në vlerësimin e procesit mësimor dhe vlerësimit të tyre, pyetësorët standard të cilat ju vihen në dispozicion studentëve dy herë ne vit në çdo fund semestri. FSHPJ, DSHP,</p>

<p>studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>analizon këto pyetësorë duke evidentuar ecurinë në mësimdhënie, duke përfshirë vazhdimisht studentet në këtë proces, dhe marrin masat e nevojshme për përmirësimin e mëtejshëm të metodologjisë së mësimdhënies. Mendimet e sugjerimet e studenteve të dalin gjatë përpunimit të pyetësorëve kanë shërbyer si pika referimi të vlerësimit të punës nga stafi angazhuar në mësimdhënie duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave.</p> <p>(Evidencë 49- Model Pyetësori i studentëve)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Format dhe metodat e mësimdhënies në programin e studimit nxisin studentët të mendojnë në mënyrë aktive duke i inkurajuar ata të punojnë edhe në grupe gjatë orëve të seminarit ku secili prej tyre mer një përgjegjësi për të përgatitur apo referuar një material. Një prej elementëve që programi inkurajon është të menduarit kritik dhe aftësimi të studentit të vepronte me autonomi në zgjidhjen e problemeve me të cilat ata përballen. Për këtë ata gjejnë mbështetje nga mësimdhënësit. Përdorimi i metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, përbën një objektivi të rëndësishëm të institucionit, e përcaktuar në dokumente kryesore strategjike të UAMD.</p> <p>(Evidencë 31_Syllabuset e lëndëve; Evidencë shtesë 3_Plani mësimor i programit të studimit; Evidencë shtesë 5-7_Programet mësimore të lëndëve; Evidencë 3.6_Rregullore e Programit të Studimit)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka të përcaktuara qartë dhe garanton të gjitha procedurat që nevojiten për vlerësim të njohurive, dijeve personale dhe aftësive profesionale të çdo studenti.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Procesi i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik (semestrave), i cili konstatohet nga vlerësimi për dy provime (i ndërmjetëm dhe përfundimtar), pjesëmarrjes aktive në seminar, detyrat e kursit dhe projektet</p> <p>Komponentët kryesorë të vlerësimit, të cilat kanë kombinime të ndryshme në lëndë janë:</p> <p>Projekt/ Detyrë Kursi: 10 % Provimi i ndërmjetëm: 40 % Provimi përfundimtar: 50 %</p> <p>(Evidencë 7, Neni 68; Evidencë 28_Draft Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 31_Syllabuset e lëndëve).</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Institucioni ka një marrëveshje bashkëpunimi pjesë e projektit Clean Score e mbështetur kjo nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim. (Evidencë 53_ Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit) Nga shqyrtimi i dokumentacionit, por edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ ne takim edhe me pesonelin akademik, ju referua se, përdorimi sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit në lëndët e këtij programi studimi që do të ndikonte në reduktimin e formave të abuzimit dhe rritjes së transparencës, përdorej në rastet kur teza ishte e hartuar vetëm me pyetje alternative. (Vizita në institucion, takimi me personelin akademik).</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në syllabuset e lëndëve janë të pasqyruara mënyrat e vlerësimit, kjo në përputhje dhe aktet ligjore dhe nënligjore. (Evidencë 31_ Syllabuset e lëndëve)</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni përmes akteve ligjore dhe nënligjore garanton të drejtën e çdo studenti për tu njohur me vlerësimin si dhe për të marrë një informacion të detajuar nga personeli akademik i kursit në lidhje me mënyrën e vlerësimit së bashku me identifikimin e gabimeve që studenti ka bërë në testim. Rezultatet e provimeve i jepen studentit brenda 72 orësh (provimi final), ku bëhet ballafaqimi i vlerësimit të tezës së provimit dhe komenteve për përmirësim nga lektori i lëndës me studentët ndërsa për provimin e ndërmjetëm 1-javë. Gjatë vizitave në institucion u konstatua se pas zhvillimit të provimeve dhe publikimit të rezultateve, pedagogët diskutojnë me studentët mbi zgjidhjen e tij, duke ndikuar në përmirësimin e dijeve në vijim. (Evidencë_ Takimi me personelin akademik dhe me studentët). Kjo e drejtë është e përcaktuar edhe në aktet e brendshme rregullatore. (Evidencë 8_ Rregullore e FSHPJ).</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>UAMD ndjek një procedurë strikte për kryerjen e provimeve si dhe mbikqyrjen e tyre. Informacione të hollësishme mbi përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira gjenden në Rregulloren e UAMD. (Evidencë 7_ Neni 90_ Rregullore UAMD).</p>

<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> <p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>72 orë nga data e zhvillimit të provimit, periudhë gjatë të cilës zhvillohen dhe seancat sqaruese, bëhet dorëzimi i vlerësimeve të provimit/eve. Vlerësimi për komponentët e tjerë dorëzohet në fund të semestrit, përpara zhvillimit të provimit përfundimtar. Secili pedagog bën shënimet përkatëse në fletën e provimit të studentë për çdo pyetje që përmban fleta e provimit. Çdo student ka të drejtën e ballafaqimit për rezultatin e provimit. Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit, sikurse dhe të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa paraqitet me shkrim tek Dekani jo më vonë se tre ditë nga marrja e vlerësimit. Dekani mund t'ja kalojë për shqyrtim përgjegjesit të njësisë bazë, departamentit, i cili vë në dijeni personelin akademik e më pas dorëzon një relacion tek drejtuesi i njësisë kryesore, Dekanit, i cili vlerëson ose jo të drejtë pretendimin e studentit. (Evidencë 7_Rregullore e UAMD, Neni 71). Nga informacioni i marrë gjatë takimit me studentët e programit të studimit, rezultatet e vlerësimit bazohen mbi meritë (Vizita në institucion, takimi me studentët).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura të drejta e transparente të aksesueshme nga palët e interesuara lidhur me përparimin e studentëve, dhe vlerësimin e dijeve në programin e studimit, duke respektuar sistemin e meritës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit garanton pajisjen e të diplomuarve me njohuri bazë mbi teoritë dhe synon përgatitjen specialistëve në media, gazetarëve dhe marrëdhënieve me publikun, me njohuri të përgjithshme në fushat përkatëse dhe duke mundësuar një karrierë të mëtejshme akademike në fushën e komunikimit, marrëdhënieve me publikun etj. Nëpërmjet këtyre njohurive, ky program studimi përgatit individë për karrierë në sektorin privat, publik dhe organizata jofitimprurëse. Ky program mundëson tek studentët kompetenca në fushën e tyre të studimit mbi, aktorët social, zhvillimet e fundme në shoqëri kompetenca në sferën praktike, duke identifikuar edhe problemet që ka shoqëria. (Evidencë 29.1_Plani mësimor i programit të studimit; Evidencë 28_Draft Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 31_Syllabuset e lëndëve).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së</p>	<p>Programi i studimit përmban lëndë për zhvillimin e aftësive në fushën e komunikimit, Teori Komunikimi dhe Komunikim Institucional. Ky program studimi lidhet me nevojën për t'ju përgjigjur kërkesave të</p>

informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	kohës dhe eliminuar përgatitjen e specialistëve me kompetencë të kufizuar, duke e shtrirë hapësirën e studimit, e duke afruar një trajtim ndërdisiplinor: Shkenca Politike, Marrëdhënie me Publikun, Administrim Publik, Shkenca Juridike, Shkenca Ekonomike, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Shkenca Komunikimi etj. (Evidencë 29.1_Plani mësimor i programit të studimit)			
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në përfundim të çdo lënde, çdo anëtar i personelit akademik bën një përmbledhje për çështjet me rëndësi ku përfshinte këtu edhe studentin, gjithashtu dhe përgatitja e një detyre apo eseje, përcakton një formë të shqyrtimit të aftësive të tyre për matjen e indikatorëve në realizimin e lëndës. (Takim me personelin akademik dhe studentët).			
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia për programin e studimit Bachelor në “Marrëdhënie me publikun” në mënyrën e realizimit, përmban dhe ofrimin e trajnimit profesional në mënyrë që studentët e diplomuar në këtë program, të kenë aftësinë për të mësuar dhe udhëhequr gjatë jetës së tyre të zotërojnë konceptet e nevojshme për të trajtuar problematikat komplekse të shoqërisë bashkëkohore. (Evidencë 78_Forum, Seminare, Workshop_e akademike të organizuara në UAMD). Një ndihmesë të veçantë në këtë trajektore nga abstraktja te konkretja e jep dhe “Praktika mësimore” e cila synon që të zhvillohen shkathtësitë e studentëve për të vendosur lidhjen nëpërmjet instrumentave njohëse që marrin gjatë procesit mësimor dhe asaj në veprim. <i>Shkëmbimet e personelit akademik dhe të studentëve të UAMD në universitetet partnere përëndimore, në kuadër të projekteve Erasmus + KAI, ishin evidente, por nuk gjetëm raste të studentëve të këtij program studimi.</i> (Evidencë 59_Të dhënat mbi mobilitetet; Evidencë 60_Praktikë për mobilitet të studentëve)			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik ishte në mbështetje dhe e konsideronte të rëndësishëm ofrimin e mundësive të të punuarit në grup, punë me projekte apo detyra kursi të cilat kërkojnë një bashkëpunim midis tyre, pasi kjo gjë i ndihmon ata të rrisin aftësitë e tyre bashkëpunuese dhe komunikuese. FSHPJ organizon periodikisht aktivitete si leksione të hapura, trajnime, orë informuese, etj. për studentët e saj. (Evidencë 78_Forum, Seminare, Workshop_e akademik e të organizuara në UAMD).			
Konkluzione	UAMD, nëpërmjet strukturave të posaçme, realizon mbi bazë kompetencash një mësimdhënie e cila është dinamike duke siguruar tek studentët përmirësim të mësimnxënies në vazhdim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në aktet e brendshme rregullatore, është përcaktuar procedura e posaçme për diplomimin, e cila mund të fitohet duke dhënë një provim të përgjithshëm formimi, i cili është alternativë me mbrojtjen e një punimi diplome, e drejtë kjo që ju takon vetëm studentëve që kanë një mesatare mbi 7. Këto dokumente dhe informacioni mbi këtë proces, u vihet në dispozicion studentëve në përfundim të semestrit të parë të vitit të tretë gjë e cila u konstatua gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi.</p> <p>(Evidencë 28_Draft Rregullore e programit të studimit; Evidencë 32_Draft rregullorja e diplomimit & 32.1_Udhëzues për temen e diplomës për ciklin e parë të studimeve FSHPJ).</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Studentët asistohen si në aspektin e informimit të tyre lidhur me procesin e provimit final apo mbrojtjes së diplomës, ashtu edhe të përgatitjes për zhvillimin e provimit apo mbikëqyrjen e punimit të diplomës (Evidencë 32_Draft Rregullore e diplomimit; Evidencë 32.1.3.4_Udhëzues i punimit të diplomës; Evidencë 28_Draft Rregullore e Programit të Studimit). Ky asistim u konstatua edhe gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi. Lëndët që do të përfshihen si dhe formati i tezës së provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomimit përcaktohen që në fillim dhe vlerësimi për provimin e përgjithshëm përfundimtar të diplomimit bëhet nga një komision, përbërja e të cilit propozohet nga departamenti dhe miratohet nga Dekani. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë të DSHPJ. Studentët e programit të cilët në përfundim të studimeve të tyre kanë një mesatare mbi 7 kanë të drejtën që të realizojnë një tezë diplome (punim) ose provim me shkrim (provimi përfundimtar). Studentët që i nënshtrohen provimit me shkrim, marrin orientime lidhur me grup lëndët dhe literaturën që duhet të shfletojnë. (Evidencë 28, Neni 37,40_Draft Rregullore e programit të studimit)</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Bazuar në aktet e brendshme rregullatore, komisioni ad-hoc për hartimin e programit të provimit të diplomës bazohet në lëndët e kategorive A, B dhe C (nga kjo kategori përjashtohen lëndët me zgjedhje, të cilat përcaktohen me vendim të DSHPJ. Pyetjet hartohen nga titullarët e lëndëve. Ky program, pas diskutimeve në departament, i dërgohet për miratim Dekanit.</p> <p>(Evidencë 28_Draft Rregullore e programit të studimit).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në</p>	<p>Personeli akademik angazhohet maksimalisht duke orientuar dhe ndihmuar studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave. Pedagogu udhëheqës gjatë seancave metodologjike trajton çështje të tilla si: literatura, trajtimi i aspekteve</p>




<p>nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>metodologjike, përdorimi i metodave cilësore dhe/ose sasiore, mbledhja dhe raportimi i gjetjeve / të dhënave, përpunimi apo analiza e tyre.</p> <p>(Evidencë 32.1_Udhëzues për temën e diplomës).</p> <p>Kriteret dhe procedurat e diplomimit janë të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore. Programi i provimit final i vihet në dispozicion studentëve në fund të semstrit të parë të viti të tretë, ndërsa për studentët që do të përgatisin temë diplome, departamenti publikon temat e mundshme të diplomave, sikurse përcakton edhe pedagogun udhëheqës, i cili asiston studentin në përgatitjen e punimit të diplomës, sipas standardeve të institucionit.</p> <p>(Evidencë 28_Draft Rregullore e programit të studimit).</p> <p>Udhëheqësi i diplomës garanton se punimi është realizuar sipas standardeve shkencore dhe përmbush kriteret institucionale për kërkimin shkencor. Përgatitja e punimit kryhet sipas një plani të dakordësuar ndërmjet udhëheqësit shkencor dhe studentit. Udhëheqësi miraton punimin përpara se studentin të paraqitet në komisionin për mbrojtjen e diplomës. (Evidencë 7_Rregullore e UAMD).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Referuar dokumentave institucionale, por edhe nga takimet me personelin akademik të këtij programi studimi, udhëheqësi i diplomës asiston studentët që ka në udhëheqje në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Parimet kryesore të Shkrimit Akademik dhe të Kërkimit, studentët i marrin që në momentin e zhvillimit të këtyre lëndëve të cilat zhvillohen që në vitin e parë semestri parë dhe dytë. (Evidencë 29.1_Plani mësimor MP). Për shkak të ciklit të studimeve dhe natyrës së programit të studimit, pritshmëria për kërkim shkencor të mirëfilltë (mbledhja e të dhënave parësore në terren) është relativisht e ulët.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësimi bëhet me notë. Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit, të cilat pasqyrohen në procesverbal, dhe i bëhet e ditur studentit nga Komisioni, jo më vonë se 72 orë nga përfundimi i provimit.</p> <p>(Evidencë 28_Draft Rregullore e programit MP)</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentin i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Studenti që kalon me sukses tezën e diplomës/provimin e përgjithshëm përfundimtar pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e diplomës. (Evidencë 32.2_Diplomë dhe suplement diplome). Në përfundim të studimeve, studentin merr një kopje zyrtare të plotë të programit të studimit të zhvilluar, sikurse dhe plan programet e plota sipas kërkesës së tij.</p> <p>(Evidencë 28_Draft Rregullore e programit MP)</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Sekretaria Mësimore menaxhon dhe administron të gjithë informacionin e studentëve ndër vite. Të gjitha të dhënat e studentëve, që nga fillimi i studimeve deri në diplomimin e tyre gjenden në databazën e Sekretarisë Mësimore, si dhe në regjistrin themeltar të notave. Sekretaria Mësimore arkivon dhe mban në dosje dokumentet e</p>

	çdo studenti që është i regjistruar, është çregjistruar, si dhe të studentëve që kanë mbaruar studimet e tyre (Evidencë 13_Rregullore për funksionimin e sekretarisë mësimore).			
Konkluzione	UAMD ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.			
Shkalla e përmbylljes së standardit	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X


Shkalla e përmbylljes së standardeve të fushës III	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbyllet standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri I. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbyllet kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	<p>Bazuar në të dhënat e përcjella nga UAMD, konfirmojmë se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Marrëdhënie me Publikun” i përshtatet kërkesave të këtij programi studimi dhe fusha kërkimore e personelit akademik të angazhuar është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p> <p>Angazhimi i personelit akademik është realizuar bazuar në kërkesat dhe modalitetet e Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Instituconet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores së Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.</p> <p>Përbërja e personelit akademik të angazhuar në 3 vitet e fundit akademike në programin e studimit, paraqitet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 20-21: 20 PAE, me kualifikimin: 3 Prof.As., 16 Dr., dhe 1 Msc. dhe 3 PAK, me kualifikimin: 1 Prof.As., dhe 2 Dr. - 21-22: 17 PAE, me kualifikimin: 1 Prof.Dr., 3 Prof.As., dhe 13 Dr., dhe 3 PAK, me kualifikimin: 1 Prof.As., dhe 2 Dr. - 22-23: 18 PAE, me kualifikimin: 3 Prof.As., dhe 15 Dr., dhe 1

	<p style="text-align: center;">PAK, me kualifikimin Dr.</p> <p>GVJ evidenton se në të dhënat e paraqitura nga IAL lidhur me personelin akademik ka disa pasaktësi/mospërputhje, të cilat, në mënyrë të përmbledhur paraqiten në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tek të dhënat e stafit akademik për vitin akademik 20-21: B.B, E.Z dhe N.P, të përfshirë tek tabela e stafit të programit, nuk mbulojnë asnjë lëndë për këtë vit akademik tek tabela 12 e planit të lidhur me stafin, ndaj nuk janë llogaritur tek të dhënat e stafit për këtë vit; V.P është përsëritur 2 herë, ndaj është numëruar vetëm 1 herë; K.M është vënë edhe PAE edhe PAK, ndaj është llogaritur vetëm si PAK pasi e tillë është tek tabela e personelit të programit; B.H është vënë si PAE tek tabela e planit të lidhur me stafin, ndërkohë që sipas tabelës së stafit është PAK, ndaj është llogaritur PAK; - t tek të dhënat e stafit akademik për vitin akademik 21-22: D.T, e përfshirë tek tabela e stafit të programit, nuk mbulon asnjë lëndë për këtë vit akademik tek tabela 12 e planit të lidhur me stafin, ndaj nuk është llogaritur tek të dhënat e stafit për këtë vit; V.P është përsëritur 2 herë, ndaj është numëruar vetëm 1 herë; H.G dhe N.P janë vënë si PAE tek tabela e planit të lidhur me stafin, ndërkohë që sipas tabelës së stafit janë PAK, ndaj janë llogaritur PAK; - tek të dhënat e stafit akademik për vitin akademik 22-23: V.P është përsëritur 2 herë, ndaj është numëruar vetëm 1 herë; - lidhur me kualifikimin akademik të personelit, janë marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në tabelën 6 të personelit akademik të programit, në evidencën shtesë të përditësuar nga IAL. <p>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit është i kualifikuar dhe zotëron tituj akademikë dhe grada shkencore, si dhe ka një eksperiencë të pëlqyeshme në mësimdhënie. Pedagogët e përfshirë në program, sipas cv dhe syllabuseve të depozituara nga secili mësimdhënës, kanë kontribute shkencore në fushat që mbulojnë, si punime doktrature, trajnime afatgjata dhe afatshkurtra, mësimdhënie në fusha të njëjta, përafërta apo të ngashme. Për të gjithë lektorët e mësimdhënësit, gjykojmë se është respektuar fusha e ekspertizës.</p> <p>(Evidenca 16_Structura Organizative e UAMD; Evidencë shtesë, personeli akademik i programit)</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Të dhënat që ka paraqitur Departamenti i Shkencave Politike për planifikimin e ngarkesës për çdo vit akademik dhe për realizimin e ngarkesës mësimore tregojnë qartë respektimin e kornizës ligjore në fuqi. Personeli akademik me kohë të plotë mbulon jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi. Përkatësisht, për 3 vitet e fundit akademike, ngarkesa paraqitet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 20-21: 90.9% PAE / 9.1% PAK;


	<ul style="list-style-type: none"> - 21-22: 90.9% PAE / 9.1% PAK; - 22-23: 97% PAE / 3% PAK. <p>(Evidenca 21_Parashikim ngarkese për programet e DSHP; Evidenca 18_Procedura dhe formularët e përdorur për rekrutimin e personelit në UAMD; Evidencë shtesë, plani i lidhur me stafin, plani mësimor dhe ndarja sipas kategorive formuese)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Kontratat e personelit dëshmojnë përbushjen e këtij kriteri. Gjatë vizitës në institucion, nga takimi me stafin e burimeve njerëzore, u evidentua se Departamenti i Shkencave Politike garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Qëndrueshmëria e personelit akademik garantohej nëpërmjet tipologjisë PAE të stafit në këtë program, personeli i cili ka kontrata pa afat dhe është i punësuar pranë IAL prej shumë vitesh, si dhe i angazhuar në këtë program që prej ditës së parë që programi është hapur, e cila u konfirmua edhe nga vizita në institucion dhe diskutimi me stafin akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program. Procedura për rekrutimin e personelit akademik është e reflektuar në Statutin e Universitetit dhe në konformitet me bazën ligjore dhe aktet normative në fuqi. Institucioni nëpërmjet DBNJPA ndjek në mënyrë rigoroz procedurat në bashkëpunim me Departamentet.</p> <p>(Evidenca 20_Marrëveshje për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedurën e rekrutimit dhe vlerësimit, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>UAMD rekruton personelin akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ në përputhshmëri të plotë me Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” (nenet 64-67), Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, Rregulloren dhe Statutin e UAMD.</p> <p>Rregullorja për rekrutimin e stafit përmban të gjitha procedurat që duhet të ndiqen për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës mësimor dhe administrativ. I gjithë procesi i rekrutimit dhe vlerësimit konform kriterëve të shpallura ndiqet dhe vlerësohet nga drejtoria e specializuar për këtë proces DBNJ, e fillon procesin pasi merr kërkesën nga njësia bazë. Në Statutin e UAMD, Rregulloren e Përgjithshme të UAMD dhe Rregulloret e tjera përcaktohen qartë të gjitha procedurat për rekrutimin e stafit akademik për realizimin e programit të studimit. Përzgjedhja e personelit akademik të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi është bërë sipas nevojave të Departamentit, i cili ka përcaktuar paraprakisht me vendim të veçantë kriteret specifike për vendet e punës.</p> <p>GVJ konfirmon që institucioni ka miratuar dhe zbaton me rigorozitet procedurën e rekrutimit dhe vlerësimit që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e kërkuar të kualifikimit.</p>

	(Evidenca 9_Kontrata e punës per personelin akademik; Evidenca 7_Rregullore e UAMD; Evidenca 1_Statuti UAMD)
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, siguron punësimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm për mirëmbajtjen dhe realizimin e orëve laboratorike dhe të mjediseve të tjera mësimore referuar rregullores së institucionit dhe strukturës organizative të tij. Numri i personelit ndihmës akademik i angazhuar në këtë program, studimi është 1 (një). (Evidenca 16_Struktura Organizative e UAMD)
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore përgatit dhe ruan përshkrimet e punës, bashkëpunon me Rektorin dhe Administratorin për plotësimin e vendeve të punës sipas strukturës së miratuar si dhe ndjek zbatueshmërinë e procedurave të punësimit të personelit të deri në firmosje të kontratës së punës; kjo zyrë ruan të dhënat zyrtare sipas akteve ligjore në fuqi. Mbledhja e të dhënave bëhet mbi bazën e një formulari tip, i cili plotësohet nga personeli me kohë të plotë dhe të pjesshme. Ruajtja e të dhënave të personelit bëhet me një dosje personale fizike, që përditesohet në bazë të informacionit të paraqitur në Zyrën e Burimeve Njerëzore. GVJ kontrolloi në mënyrë rastësore dosje të personelit akademik dhe evidentoi se dokumentacioni i tyre ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit dhe rregulloreve të institucionit. (Evidenca 36_Rregullore e mbajtjes së bazës së të dhënave të kërkimit shkencor; Evidenca 37_Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore)
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Të dhënat e paraqitura për këtë program studimi tregojnë se Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor në Marrëdhënie me Publikun. Kapacitetet e UAMD-së dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike në përmbushje të praktikës profesionale dhe në funksion të punimit të temës së diplomës. Në kuadër të procesit të kryerjes së praktikës profesionale, UAMD dhe Departamenti i Shkencave Politike janë angazhuar në realizimin e marrëveshjeve me organizata të ndryshme në nivel vendor apo qendror. <i>GVJ rekomandon vijimin e angazhimit nëpërmjet marrëveshjeve me palët e treta për të mundësuar e udhëhequr praktikën e studentëve, kjo nëpërmjet marrëveshjeve të cilat adresojnë në mënyrë specifike këtë program studimi.</i> (Evidenca. 113_Tabela për programet “Bachelor në Marrëdhënie me Publikun”; Evidenca 53_Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit)
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në	Një rëndësi e veçantë i kushtohet aftësisimit të studentëve për të

<p>ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>realizuar jo vetëm aplikimin e njohurive praktike, por edhe zhvillimin e mendimit kritik si dhe të aftësive kërkimore të tyre. Programi i studimit nëpërmjet praktikës synon të ofrojë njohuritë e nevojshme për studentët që synojnë të vazhdojnë formimin e tyre akademik për të ndjekur edhe ciklin e dytë të studimeve. Raporti përfundimtar përpilohet e dorëzohet. Vlerësimi final hidhet në procesverbalin përkatës.</p> <p>(Evidenca Nr. 33 Rregullore e zhvillimit të praktikës në Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Personeli akademik që mbulon programin e studimit ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. GVJ evidenton se në të dhënat e paraqitura nga IAL lidhur me personelin akademik ka disa pasaktësi/mospërputhje, të cilat, në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur me lart.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon vijimin e angazhimit nëpërmjet marrëveshjeve me palët e treta për të mundësuar e udhëhequr praktikën e studentëve, kjo nëpërmjet marrëveshjeve të cilat adresojnë në mënyrë specifike këtë program studimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri I. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore. në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Politike Juridike ka mjediset të mjaftueshme mësimore për të siguruar veprimtarinë mësimore të programit të studimit. FSHPJ disponon rreth 1700 ulëse për të zhvilluar mësimin në të njëjtin orar mësimor.</p> <p>Për realizimin e programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie me Publikun”, FSHPJ ka mjediset mësimore të përshtatshme dhe të mjaftueshme për numrin e studentëve për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse, për të zhvilluar mësimin në të njëjtin orar. Mjediset janë në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. UAMD ka në funksion për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse ambjentet në Kampusin Universitar godina 1 dhe godina 2 si dhe godinën qendrore në Curila.</p> <p>GVJ vizitoi mjediset e godinës dhe konfirmon se ato plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral dhe ishin të pajisura me sistem ngrohje. Biblioteka po ashtu ishte në një ambjent të përshtatshëm me ajër dhe hapësira studimi të mjaftueshme.</p>

	<p>Personeli akademik ka një zyrë të veçantë, e cila shërben edhe si zyrë mbledhesh dhe takimesh. IAL disponon gjithashtu auditorë për leksione/seminare, salla kompjuteri dhe laborator, sallë interneti, të pajisura me infrastrukturën bazike mësimore. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerëzore, Biblioteka janë të akomoduar në sallat e tyre përkatëse në godina të të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktivitetit të tyre.</p> <p>(Evidenca 68_Dokumentacion mbi asetet, objektet, pasuritë e IAL dhe politika e pronës)</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset janë të pajisura me mjetet e nevojshme në mënyrë që të shfrytëzohet teknologjia bashkëkohore në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Njësia kryesore disponon edhe një laborator. <i>Nxitet pajisja e pasurimi i mëtejshëm i këtyre mjedisëve edhe me mjete të tjera e pajisjet më të fundit teknologjike, apo pajisja e çdo auditori me video-projektor.</i></p> <p>(Evidenca 65.1_Biblioteka online. Të dhëna mbi materialet e disponueshme)</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>FSHPJ ka në dispozicion auditorë bashkëkohore të nevojshëm për plotësimin e kërkesave të lëndëve, apo moduleve të programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie me Publikun”. GVJ, gjatë vizitës në institucion, konfirmon se mjediset e vëna në dispozicion përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve siç janë vidioprojektorët, mjetete audiovizive, interneti apo edhe dërrasat e shënimeve, të cilat mundësojnë aftësimin teorik e praktik dhe realizimin e objektivave formues të programit të studimit punonjës social. Për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit janë në dispozicion zyra dhe dhe pajisje kompjuterike të cilat krijojnë kushte normale për realizimin e detyrave për programin e studimit.</p> <p>(Evidenca 83_Laboraret; Evidenca 68_Dokumentacion mbi asetet, objektet, pasuritë e IAL dhe politika e pronës)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka siguruar një laborator të teknologjisë së informacionit në njësinë kryesore ku ofrohet programi i studimit në proces vlerësimi. GVJ gjatë vizitës në institucion vizitoi laboratorin e teknologjisë së informacionit, i cili ishte i pajisur me programet profesionale, laboratorin ishte në dispozicion të studentëve për të realizuar detyrat, disa orë edhe për mësimdhënie edhe për takimet apo projektet e ndryshme studentore.</p> <p>(Evidenca 67_Strategjia e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit 2020-2025; Evidenca 83_Laboraret)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Mjediset mësimore dhe infrastruktura e vënë në dispozicion nga IAL është e përshtatshme, garanton realizimin e procesit mësimdhënës dhe formimin teorik dhe atë praktik, të posaçëm referuar natyrës dhe</i></p>

	<i>fushës së studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p><i>Referuar evidencave mbi fondin e bibliotekës rezulton se nuk ka mjaftueshëm literaturë fizike në gjuhën shqipe dhe në atë angleze (tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme) të përshtatshme me nevojat e programit të studimit.</i></p> <p>Fondi i librave mund të konsultohet gjithashtu online. Bazuar në kërkesat e personelit akademik fondi është zgjeruar për çdo vit akademik dhe është vendosur në shërbim të studentëve. Kjo mundësohet nga tekste mësimorë të përkthyer nga Shtëpitë Botuese, tekste mësimorë të shkruar nga stafi pedagogjik dhe tekste mësimorë të përkthyer në kuadër të projektit CleanScore të AADF.</p> <p>Spektori i IT mundëson integrimin e teknologjisë së informacionit në Bibliotekën Shkencore në bashkëpunim me Drejtoreshën e Bibliotekës. Ai administron dhe kujdeset për funksionimin e mirë të rrjetit të bibliotekës, të dy sistemeve.</p> <p><i>(Evidenca 65_Biblioteka online të dhëna mbi materialet e disponueshme).</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Biblioteka e universitetit njofton për përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit qoftë në gjuhën shqipe dhe atë të huaj.</p> <p>Plani financiar i programit të studimit përmban zëra të veçantë për shtimin dhe përditësimin e zërave të bibliotekës për programin e studimit.</p> <p>Nga RVB dhe takimet në Departament evidentohet fakti që DSHP diskuton dhe miraton programet mësimore të lëndëve dhe moduleve të programit të studimit lidhur me përditësimin e literaturës dhe ndjek botimet e reja nga të gjitha burimet që disponon, sidomos ato që lidhen drejtëpërdrejtë me kurrikulën e programit të studimit Bachelor në Marrëdhënie me Publikun me synimin për t'i përditësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien.</p> <p>(Evidenca 65.1_Biblioteka)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Studentët e programit të studimit Bachelor në Marrëdhënie me Publikun kanë mundësi të shfrytëzojnë edhe bibliotekën elektronike. Biblioteka Shkencore e UAMD qarkullon mbi 20.000 njësi bibliotekare në vit, ndërkohë që numri i frekuentuesve është rreth 2000 përdorues në sallën e leximit, ajo është në dispozicion të</p>

	<p>studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Salla është në shërbim të plotë të studenteve, pedagogëve e studiuesve çdo ditë të javës, nga ora 8:00-16:00.</p> <p>(Evidenca 65.1_Biblioteka; Evidenca 65.2_Rregullorja e Bibliotekes UAMD; Evidenca Nr. 65 Manual dhe Informacion për Bibliotekën Online)</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka universitare garanton literaturë kryesisht të viteve të fundit, tekste mësimore dhe plotësuese, rreth 7000 libra fizike që i shërbejnë programeve të studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë dhe 6500 që i shërbejnë detyrave dhe projekteve.</p> <p>Megjithatë, sikurse cituar dhe më lart, referuar evidencave mbi fondin e bibliotekës rezulton se <i>nuk ka mjaftueshëm literaturë fizike në gjuhën shqipe dhe në atë angleze (tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme) të përshtatshme me nevojat e programit të studimit, ndaj rekomandohet vijimi i përditësimit dhe pasurimit të saj me literaturë të aksesueshme e në përshtatje me nevojat e formimit specifik të këtij programi studimi.</i></p> <p>(Evidenca 65.1_Biblioteka)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Krijohen kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online në dispozicion të programit të studimit.</p> <p>Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ konfirmoi UAMD ka anëtarësim të plotë në JSTOR.</p> <p>UAMD është abonuar në libraritë elektronike si EBSCO, biblioteka digjitale që përmbajnë revista akademike që mund të aksesohen lirisht nga studentët dhe stafi akademik. UAMD është gjithashtu pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike on line) një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet erajonit të Europës Juglindore. Si anëtare e Konsorciumit të Bibliotekave Akademike në Shqipëri, përmes projektit ERA2012 (Electronic resources for Albania) lexuesit përfitojnë akses në një gamë të gjerë të burimeve elektronike me tekst të plotë. UAMD fitoi statusin “EU Info Point” me anë të së cilës mbërrijnë në bibliotekën e UAMD periodikisht publikime nga Zyra e Publikimeve të BE-së në Luksemburg. Biblioteka e UAMD është pjesë e ALASE (Albanian Academic Research Engine)</p> <p>Çdo anëtar i personelit akademik dhe student ka akses në koleksionet e U-Library dhe mund të aksesojnë disa artikuj në mënyrë periodike.</p> <p>(Evidenca 65.1_Biblioteka; Evidenca 65.2_Rregullorja e Bibliotekes UAMD)</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që</p>	<p>Biblioteka e UAMD është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Koleksioni përpunohet nga ana shkencore</p>

mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	bibliografike konform standardeve ndërkombëtare duke përdorur UDC (sistemi i klasifikimit), ISBD (International Standard Bibliographic Description), formatin MARC, Z39.50 SRU. Per të aksesuar shërbimin e libraries digjitale, fillimisht aksesohet në linkun: https://ulibrary.rash.al/ dhe Faqja kryesore e shërbimit përmban krahas një videoje informuese dhe hapat kryesore që duhet të ndiqen. (Evidenca 58_Njoftim mbi perdorimin e Digital Library per staf dhe studente)
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Orari i bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit. Gjatë sezonit të provimeve është e hapur me orar të zgjeruar. (Evidenca 65_Rregullore e Bibliotekes)
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit. shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ-së gjatë bisedës ju konfirmua se çdo student dhe lektor ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë. Studentëve i vihet në dispozicion kartela e regjistrimit me të dhënat personale dhe pajiset me librezë anëtarësie. Ai ka të drejtë të përdorë kompjuterat e sallave, për lundrim në burimet elektronike, ose përdorimin e katalogut elektronik. Me shfrytëzimin e sistemeve me bazë “kod të hapur”, mbështetur në udhëzimet e BE-së, Nenit 179 të Traktatit të Lisbonës mbi burimet e hapura (open access), me mbështetjen e IFLA-s, biblioteka e Universitetit ka instaluar falas Katalogun Online të Integruar, për menaxhimin e fondit të saj. Çdo vit, sipas kërkesave të stafit akademik përgatitet lista e blerjeve për të pasuruar fondin e Bibliotekës. Kërkesat evidentohen në Departament të cilët në fillim të vitit akademik diskutojnë programet e lëndëve, ndryshimet, përmirësimet dhe përcaktojnë kërkesën për literaturën. Nga takimi me stafin u konfirmua fakti që institucioni i merr në konsideratë kërkesat e tyre për literaturë plotësuese po per këtë vit akoma nuk ishte miratuar lista e librave të kërkuar nga departamenti. <i>Nuk gjenden raporte analitike mbi efektshmërinë e investimeve në pasurimin e fondit fizik dhe atij online.</i> (Evidenca 65_Rregullore e Bibliotekes; Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik, studentët dhe përgjegjës in e Bibliotekës)
Konkluzione	<i>Studentëve të programit të studimit, u ofrohet infrastrukturë e përshtatshme për procesin e mësimnxënies. Rekomandohet pasurimi e përditësimi me literaturë i bibliotekës për programin e studimit në proces vlerësimi. GVJ gjykon se shtimi i fondeve përmes blerjeve është një praktikë e cila duhet marrë vëmendje nga njësia bazë, të analizohet dhe të ndërtohen plane konkrete veçanërisht për fondin fizik të librit shqip, pasi kështu mund të mundësohet pasurimi i fondeve dhe përditësimi i literaturës në punë sociale, e cila është</i>

	<i>domosdoshmëri për procesin e formimit teorik të studentëve në këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UAMD përmban informacion personal të studentit dhe adresat e tyre elektronike. Studentët gjithashtu, informohen nga faqja zyrtare e UAMD, rrjetet sociale, në ambientet brena godinës si dhe nga sistemi Pitagora. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës ka faqen zyrtare zonën e studentit e cila informon studentët me të gjitha njoftimet, si edhe përmban informacion në lidhje me: manifesti i studentit, shkëmbime dhe praktika, orari, lidhshipi studentor, zyra e komunikimit Alumnit dhe karrierës, bursa dhe tarifa, etj. Përmes sistemit të integruar “Pitagora” parashikohet realizimi i komunikimit midis studentëve dhe stafit. Këto sisteme lehtësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve dhe informacionit. (Evidenca 72_Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH))
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Departamenti i Shkencave Politike administrojnë dokumentacionin përkatës për partnerët dhe për stafin e angazhuar në këtë program studimi. Sistemi i UAMD-së për ruajtjen e informacionit të personelit bazohet në arshivimin e dokumentacionit në formën hardcopy dhe elektronike dhe kjo ka rezultuar efektive. Departamenti dhe Zyra e Burimeve Njerëzore ruan CV-të, ngarkesat dhe dokumenta të tjera të nevojshme që lidhen me veprimtarinë e personelit. (Evidenca 72_Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH); Vizita në Institucion)
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Platforma Pitagora mundëson transmetimin e vlerësimit të dijeve të studentëve nga lektori te studentit. Platformë prezente edhe në ciklin e dytë. Bëhet i mundur komunikimi dhe përcjellja e informacionit tek studentët. (Evidenca 72_Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH); Vizita në Institucion)
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet	Faqja zyrtare e internetit e UAMD përmban të gjitha informacionet mbi personalin akademik, programet e studimit, aktivitete, njoftime në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Njësia kryesore ka ngritur struktura të cilat mundësojnë monitorimin dhe raportimin në kohë reale të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43 123

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

40

dhe autoritetet drejtuese.	aktivitetit akademik dhe administrativ			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	<i>Gjatë vizitës GVJ konstatoi që departamenti nuk ka një politikë të standardizuar apo manual për publikimin, por kryesisht të gjithë aktivitetet publikohen në faqen eeb të institucionit.</i> (Evidenca 15_ Strategjia e komunikimit UAMD)			
Konkluzione	<i>Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit është i kompletuar dhe mbështetës në vijimësinë e aktiviteteve të institucionit për programin e studimit në proces vlerësimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Buxhetimi financiar në nivel institucioni bëhet çdo vit. Raportet financiare hartohen në bazë institucioni dhe janë të ndara sipas Cikleve dhe programeve të studimit. Planifikimi i financimit realizohet në mënyrë paraprake për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit. (Evidenca 47_Analiza e Departamentit të Shkencave Politike 2021-2022)
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Plani i financimit hartohet në nivel institucional dhe përmban të gjithë elementët financiarë në bazë programi. Plani i financimit të programit të studimit përmban elementet dhe zërat specifik për financimin e tij, si: orë mësimore të realizuara nga personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, shpenzimet e ndryshme operative etj., kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe çdo zë tjetër të nevojshëm. <i>Për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve të programit, do të këshillojm që njësia bazë të aftësohet në proceset e financimit, shpenzimeve, detyrimeve financiare apo dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit, për të garantuar edhe në këtë drejtim autonominë e njësisë bazë, sipas frymës së ligjit.</i> (Evidenca 47_Analiza e Departamentit të Shkencave Politike 2021-2022; Evidenca 48_Analiza Vjetore e Departamentit të Shkencave Politike, 2018-2019)
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Auditimi financiar dhe raportimi financiar janë procedura të përvitshme të dokumentuara që dëshmojnë vlerësimin financiar të institucionit, bazuar në raportet e auditimit dhe të dhënat financiar. Njësia e Auditimit të Brendshëm ka për detyrë realizimin e auditimit të brendshëm, në përputhje me planet e miratuara. UAMD kryen

	<p>auditim të veprimtarisë nga njësitë e auditimit të brendshëm. Institucioni ka raporte auditimi të brendshëm çdo vit. Auditimi financiar dhe raportimi financiar janë procedura të përvitshme të dokumentuara që dëshmojnë efektivitetin financiar të UAMD.</p> <p>(Evidenca 3_Plani i zhvillimit strategjik UAMD; Vizita në Institucion)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Institucioni disponon raportet financiare për çdo vit akademik. Plani i financimit hartohet në nivel institucioni dhe përmban elementët financiarë për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të programit të studimit.</p> <p>Institucioni raporton në mënyrë periodike për realizimin e buxhetit, për rishikimin dhe për rialokimin e buxhetit, sipas ligjit mbi buxhetin. Institucioni harton Raport Financiar, si pjesë e raportit vjetor dhe buxhetit të miratuar</p> <p>UAMD raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Institucioni disponon raportet financiare për çdo vit akademik.</p> <p>(Evidenca 3_Plani i zhvillimit strategjik UAMD; Vizita në Institucion)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Të dhënat financiare dëshmojnë se institucioni siguron qëndrueshmëri dhe kapacitete financiare për gjenerimin e të ardhurave gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe për të ardhmen.</p> <p>(Evidenca 47_Analiza e Departamentit të Shkencave Politike 2021-2022)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Garantohet financimi dhe mbështetja financiare e nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtja e programit të studimit dhe mbështetja e studentëve. Për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve të programit, do të këshillojmë që njësisia bazë të aftësohet në proceset e financimit, shpenzimeve, detyrimeve financiare apo dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit, për të garantuar edhe në këtë drejtim autonominë e njësisë bazë, sipas frymës së ligjit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Pranimi i studentëve në këtë program studimi është paraqitur në rregulloren e programit të studimit. Bazuar në parashikimet në aktet e brendshme rregullatore të UAMD, vihet re se në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës procesi që nga hyrja deri në daljen e studentëve në të gjithë ciklin e studimit, mbështetet në politika dhe procedura të cilat janë në respektim të plotë të legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore të institucionit. Konkretisht për regjistrimet në këtë cikël studimi, pranohen studentët bazuar në kuotat e pranimi dhe kriteret e përzgjedhjes së miratuara nga MAS. (Evidenca 8_Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike 2020)
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i Statutit dhe Rregullores së institucionit, GVJ konstatoi se politikat dhe procedurat që ndjek UAMD nga hyrja në daljen e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Respektohen detyrimet ligjore mbi regjistrimin, dhe ngrihet një komision ad hoc, i cili pas shqyrtimit të listës së aplikantëve shpall dhe listën e kandidatëve fitues për programin e studimit “Marrëdhënie me Publikun”. Bazuar në Statutin e Ri UAMD (neni 57, pika 4; neni 58, pika 5; neni 64; neni 76; neni 89), Statuti i Vjetër UAMD (neni 26, pika 1, 3, 4; neni 27; neni 30); Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Rregulloren e Programit të Studimit bachelor në “Marrëdhënie me Publikun”, vihet re se barazia dhe të drejtat e njëjta në hyrje dhe në dalje për të gjithë kandidatët janë vlera të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës si edhe të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike si një ndër njësitë e tij. Ato garantohen nëpërmjet politikave dhe procedurave që nga seleksionimi, rekrutimi, trajnimi dhe formimi i kandidatëve për studentë, e studentëve të programit të studimit në të gjithë ciklin e studimit. (Evidenca 1_Statuti UAMD; Evidenca 51_Tabelë përmbledhëse me numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në FSHPJ 2019-2023; Evidenca 52_Statistika Studentë në DSHK 2018-2022)
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura	Nga evidencat e vëna në dispozicion dhe raportimi i GVB, institucioni ka një praktikë të mirëpërcaktuar në baza vjetore për kriteret e kandidatëve për programin e studimit, përfshirë këtu edhe studentët e huaj. Institucioni bashkëpunon me QSHA-në në zbatim të maturës

<p>në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse GVJ konfirmon sipas vendimit të Senatit për Kriteret e Pranimit të Studenteve për studentë për ciklin e parë të studimeve Kriteret e veçanta që duhen përmbushur nga ana e kandidatëve hartohen dhe bëhen publike si nga ana e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Fakultetit të Shkencave Politike Juridike dhe nga DSHP në fillim të çdo viti akademik. Gjithashtu edhe Zyra e Këshillimit të Karrierës informon mbi kriteret e pranimit dhe fokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin (Evidenca 25_Vendimet për përcaktimin e kriterëve të pranimit të studentëve)</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ, mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL, konfirmon që kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve janë në përputhje me VKM në fuqi dhe ka edhe një Vendim senati për kuotat. Edhe procedurat për përparimin e studentëve, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e institucionit. Nga materialet në dispozicion dhe praktikës së mënyrës së funksionimit të procedurave të ndryshme përfshirë edhe pranimin e përzgjedhjen e studentit, programi i transparencës në universitetin “Aleksandër Moisiu” mbështetet në parimin e të drejtës për informim që është një e drejtë kushtetuese të cilën e gëzon çdo person për tu njohur me informacionin publik në përputhje me nenin 3 të ligjit për të drejtën e infomimit mbi statutin e UAMD, rregulloren si dhe në kodin e Etikës së tij, etj. (Evidenca 1_Statuti UAMD; Evidenca 8_Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidenca 7_Rregullore e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës)</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Nëpërmjet kanaleve të mjeteve të komunikimit bëhet i mundur informimi i publikut të interesuar. GVJ gjatë vizitës në IAL konfirmoi organizimin e ditëve të informimit për maurantët e shkollave të mesme, kryesisht të rajonit dhe konform një plani. Gjithashtu maurantët ftohen në kampus dhe marrin informacion të detajuar për fakultetin dhe për programe specifike të studimit. Ata informohen gjithashtu për kriteret e pranimit dhe kërkesat për t'u regjistruar. Maurantëve iu jepet mundësia të takohen dhe me stafin akademik të programit të studimit për të cilin kanë interes. Në mbështetje të Programit të Transparencës së UAMD, njoftimet nga faqja ëeb UAMD: https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/, kandidatët për studentë, të gjithë të interesuarit dhe publiku i gjerë udhëzohen përpara fillimit të çdo viti akademik në lidhje me kriteret e ve,135anta</p>
	<p>dhe të përgjithshme për pranimin në programin përkatës të studimit si nga ana e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Fakultetit të Shkencave Politike Juridike dhe DSHP. (Evidenca 1_Statuti UAMD)</p>




<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> <p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik, këto kritere bëhen të qarta dhe publike. Kriteret pasi shqyrtohen në dekanat, i përcillen Senatit Akademik, i cili mer vendimin përkatës dhe publikohen në faqen zyrtare të UAMD https://uamd.edu.al/ep-content/uploads/2023/03/KRITERET-UAMD-2023-2024.pdf. Për sa i përket kuotave, ato i përcillen Bordit të Administrimit për miratim. Pas përfundimit të procedurës nga IAL-ja, kriteret dhe kuotat i përcillen MAS në afatet e përcaktuara. IAL ka të përcaktuara gjithashtu edhe kuota të veçanta për kandidatë të kategorive të veçanta, shtresave të marginalizuara apo kandidatë të trojeve.</p> <p>(Evidenca 25_Vendimet për përcaktimin e kritereve të pranimit të studentëve; Evidenca 35_Rregullore për Studentët me Aftësi të Veçanta)</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>UAMD ndjek një politikë mbështetëse për studentët e kategorive sociale të veçanta. Për këtë kategori, parashikohen kriteret për përfitimin e bursave bazuar në aktet ligjore në fuqi dhe rregulloret e brendshme të UAMD. Kriteret dhe informacioni për përfitimet publikohen nga në faqen zyrtare dhe iu komunikohen nga strukturat e UAMD të interesuarve edhe me kanale të tjera komunikimi dhe me komunikim të drejtpërdrejtë. Studentët plotësojnë Formularë Aplikimi për Trajtimin me Bursë. Kjo kategori përfiton bursë në masën 100% ose 50%.</p> <p>(Evidenca 25_Vendimet për përcaktimin e kritereve të pranimit të studentëve)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura të qarta, publike dhe të aksesueshme nga palët e interesuara për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Sistemi Pitagora mundëson një menaxhim të integruar të dhënave për programin akademik dhe kurrikulën përkatëse të programit të studimit, stafin akademik dhe studentët. Baza ligjore e njësishë përkatëse që menaxhon programin e studimit, gjithashtu parashikon nevojën e ofrimit të një informacioni të plotë dhe transparent për programin e studimit. Kalimi nga një vit akademik në tjetrin dhe progresi akademik i studentëve në Universitetin “Aleksandër Moisiu”</p>

	<p>Durrës mundësohet nëpërmjet ofrimit të një informacioni të plotë dhe transparent nga ana e DSHP. GVJ konfirmon se studentët ishin të informuar mbi detyrimet e përgjithshme të programit të studimit si dhe për detyrimet specifike për çdo lëndë nga pedagogu përgjegjës. (Evidenca 8_Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidenca 28_Draft Rregullore e programit MP Bachelor)</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat për njohjen e studimeve dhe kualifikimeve të mëparshme janë të përcaktuara nga institucioni dhe të kuptueshme e të aksesueshme nga kandidatët për studentë dhe për të gjithë të interesuarit. (Evidenca 8_Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Evidenca 7_Rregullore e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës)</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Informacioni gjendet nëpërmjet faqes zyrtare të UAMD, faqeve sociale të fakultetit, broshurave dhe katalogut studentor si edhe gjatë shpërndarjes dhe shpjegimit të syllabuseve. (Evidenca 13_Rregullore e sekretarisë mësimore në Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se, bazuar në Rregulloren e Re UAMD (nenet 75-78); Rregulloren e Vjetër UAMD (nenet 56-60); rregulloren e FSHPJ, kriteret dhe procedurat e diplomimit të programit të studimit janë të përcaktuara, të kuptueshme dhe aksesueshme nga studentët duke vënë në dispozicion strukturat përkatëse përgjegjëse ashtu edhe kanale e mjete të ndryshme komunikimi. Baza ligjore respektive e plotë dhe e aksesueshme në nivel institucional dhe njësie përgjegjëse për programin e studimit. (Evidenca 7_Rregullore e UAMD 2018; Evidenca 8_Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike 2020; Evidenca 77_Njoftime për punësim të studentëve dhe alumni)</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Oferta akademike për programin e studimit promovohet nga institucioni sipas bazës ligjore në fuqi. Vlen për tu përmendur iniciativa e njësisë bazë për të vijuar procesin e promovimit tek targeti i studentëve të ardhshëm të interesuar nëpërmjet fletpalosjeve, faqes zyrtare të internetit të UAMD dhe rrjeteve sociale. (Evidenca 79.1_Udhëzues-Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës; https://uamd.edu.al/dokumentacioni-per-te-aplikuar/.)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Përmes dokumenteve bazë, si dhe angazhimit në nivel departamenti përgjegjës për programin e studimit organizohen takime informuese dhe orientuese me studentët, në të cilat prezantohen elementët e programit të studimit, plani mësimor, kohëzgjatja e programit, struktura e institucionit, kjo në bashkëpunim edhe me personelin ndihmës administrativ. Ndërsa në fillim të çdo viti akademik të tre vitet e studimit informohen hollësisht mbi detyrimet akademike dhe periudhën e provimeve. Informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, listën e programeve dhe të lëndëve, tarifat e studimit, si dhe parakushtet e lëndëve gjendet gjithashtu edhe në faqen web të universitetit. (Evidenca 66_Java e Orientimit dhe Guida e Studentit)
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Bazuar në të dhënat nga Programi i Transparencës së UAMD, Rregullorja e programit të studimit bachelor në “MP”, e përditësuar dhe e publikuar në faqen zyrtare ëeb, DSHP, nëpërmjet Javës së Orientimit dhe Guidës së Studentit, i orienton studentët në mënyrë të vazhdueshme. Studentët kanë akses të plotë dhe transparent mbi dokumentacionin/udhëzuesit e lëndëve/moduleve, përmbajtjen e tyre si dhe aktivitetet formuese të ndërlidhura me to. Gjatë vizitës në institucion GVJ iu konfirmua që studentët njihen që ditën e parë me rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit. (Evidenca 66_Java e Orientimit dhe Guida e Studentit; Evidenca 28_Draft Rregullore e programit MP Bachelor)
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Njësia përgjegjëse bazë/kryesore në bashkëpunim edhe me strukturat në nivel institucional (Zyra e Alumni dhe Shërbimeve Akademike) orientojnë dhe informojnë studentin në lidhje me tregun e punës. <i>GVJ rekomandon që Zyra e karrierës duhet të zgjerohet dhe shtohet me burime njerëzore.</i> (Evidenca 79.1_Udhëzues - Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës; Evidenca 50_Të dhëna ALUMNI për punësimin e studentëve të UAMD)
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Gjatë takimeve dhe seancave orientuese studentët marrin gjithashtu informacion mbi logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet që u ofrohen për të realizuar studimet e tyre. <i>Gjatë takimeve në institucion, GVJ konfirmon se informacioni që ju vihej në dispozicion nuk ishte ishte i plotësisht shterues (mungonte informacioni lidhur me shërbimet që ofrohen nga zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës).</i> (Evidenca 79.1_Udhëzues - Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe

	Karrierës; https://uamd.edu.al/; Vizita në institucion, takimi me studentët)			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Studentit i ofrohet informacion i përditësuar nga faqja zyrtare ëeb: https://uamd.edu.al/departamenti-i-shkencave-politike/ . Gjithashtu, përdoren edhe platforma të tjera bashkëkohore për të shpërndarë informacion lehtësisht të aksesueshëm dhe të detajuar lidhur me programin e studimit, në mënyrë të vazhdueshme e të përditësuar edhe në distancë. (Evidenca 13_Rregullore per funksionimin e sekretarise mesimore; https://uamd.edu.al/)			
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se studentët ishin të informuar mbi objektivat objektivat formuese të secilës lëndë; kishin informacion të plotë e të hollësishëm për strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet por mungonte informacion lidhur me shërbimet që ofron Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. GVJ rekomandon që Zyra e Karrierës duhet të zgjerohet dhe shtohet me burime njerëzore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	UAMD disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. GVJ vizitoi sekretarinë mësimore ku mbahen regjistrat në lidhje me regjistrimin, ecurinë akademike dhe diplomimin e studentëve. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është më i ulët sesa kuotat e miratuara. Sipas drejtuesve të njësisë bazë dhe njësisë kryesore në këtë trend ka ndikuar situata e përgjithshme e numrit të studentëve në vend, kryesisht emigracioni. (Evidenca 1_ Statuti UAMD Neni 92, Neni 93; Evidenca 8_Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, Neni 89; Evidenca 47_Analiza e Departamentit të Shkencave Politike 2021-2022; Evidenca 51_Tabele permbledhese me nr e studenteve te regjistruar dhe diplomuar ne FSHPJ 2019-2023; Evidenca 50_Të dhëna ALUMNI për punësimin e studentëve të UAMD; Vizita në institucion, takimi me sekretarinë mësimore)
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe	Statistikat e vëna në dispozicion nga institucioni dëshmojnë informacion të plotë nga regjistrimi në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre. Sekretaria mësimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, të larguar, të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-13 123

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

48

<p>largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>çregjistruar, etj, duke u bazuar në procedurat e përcaktuara në rregulloren e UAMD. Statistikat e përgatitura ruhen në hard dhe soft copy. Të dhënat statistikore dërgohen brenda afateve të përcaktuara pranë drejtorisë së Statistikave në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. UAMD disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të cilët janë regjistruar në programin e studimit të ciklit të parë sipas kritereve të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë.</p> <p>(Evidenca 72_Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH); Vizita në institucion, takimi me sekretarinë mësimore)</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Bazuar në Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, të dhënat për studentët janë konfidenciale dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Të dhënat ruhen konform akteve rregullatore të Universitetit. Të dhënat statistikore të studentëve përgatiten dhe ruhen elektronikisht si edhe në dosje fizike nga personat e autorizuar. Me përfundimin e sezonit të provimeve apo riprovimeve dhe depozitimit të procesverbaleve me notën përfundimtare, kryesekretaret në bashkëpunim me sekretaret mësimore kryejnë pasqyrimin e notave në bazën elektronike të të dhënave konformë manualit per funksionimin e sekretarise.</p> <p>(Evidenca 1_Statuti i UAMD; Vizita në institucion, takimi me sekretarinë mësimore)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Mbështetja e procesit të kontrollit periodik është qartësisht e evidentuar në bazën ligjore në nivel institucioni e njësie.</p> <p>Nxitet vijueshmëria e procesit të kontrollit periodik pranë njësive përkatëse për menaxhimin e informacionit.</p> <p>UAMD ka hartuar manualin per funksionimin e sekretarisë mësimore ku shpjegon qartë jo vetëm saktësinë per ruajtjen e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, por edhe mënyrën e kryerjes në mënyrë periodike të kontrolleve për vlerësimin e të gjitha njësive përgjegjëse për menaxhimin, përfshirë sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit etj.</p> <p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Të gjithë përdoruesit kishin akses të personalizuar sipas roleve të tyre dhe njësive përkatëse në sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve. GVJ bëri verifikime të të dhënave të studentëve të regjistruar e të transferuar, si dhe të ecurisë akademike në mënyrë rastësore dhe nuk konstatoi mangësi.</p> <p>(Evidenca 13_Rregullore per funksionimin e sekretarise mesimore; Vizita në institucion, takimi me sekretarinë mësimore)</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e</p>	<p><i>Nuk ka ndonjë studim të mirëfilltë të fokusuar të njësisë bazë për studentët që mbarojnë këtë profil.</i> Sidoqoftë, nje vlerësim i përgjithshëm i tregut, vlerësimi i deritanishëm i punësimeve të studentëve të këtij programi që janë diplomuar më parë është i</p>

shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	dobishëm për ecurinë e programit dhe Institucioni i ka kapacitetet për ta realizuar këtë aspekt. (Evidenca Nr. 51 Tabelë përmbledhëse me numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në FSHPJ 2019-2023; Evidenca Nr. 52 Statistika Studentë në DSHK 2018-2022)			
Konkluzione	<p><i>UAMD disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</i></p> <p><i>Nuk ka ndonjë studim të mirëfilltë të fokusuar të njësisë bazë për studentët që mbarojnë këtë profil. Meqënëse fusha dhe tregu i mundshëm i punës i të diplomuarve të këtij programi është i larmishëm, institucioni të vazhdojë të testojë e studiojë më në gjërësi tregun dhe të adresojë treguesit e studimit siç duhet për studentët e rinj në programin e studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Rregullorja e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Kreu VI, Neni 115, përcakton përfaqësimin e studentëve në organet e UAMD, marrjen pjesë në të gjitha proceset e vendimmarrjes së Universitetit, ku këshillat e studentëve kanë të drejtë të promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe të koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet e UAMD-së dhe njësisë kryesore si edhe të shprehin mendime dhe propozime për programet e studimeve të UAMD-së, rregulloret dhe veprimtaritë mësimore.</p> <p>Studentët e programit të studimit Bachelor në "Marrëdhënie me Publikun" shprehin opinionin e tyre në lidhje me tema të cilat prekin Universitetin si edhe jetën e tyre studentore, duke marrë pjesë edhe në Komisionin për garantimin e standardeve dhe cilësisë së institucionit, ndërsa në nivel Fakulteti studentët angazhohen në Komisione ad-hoc, apo Këshillat Studentore.</p> <p>(Evidenca 7_Rregullore e UAMD)</p>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p>Gjatë vizitës GVJ konfirmoi se përfshirja e studentëve mundësohej nëpërmjet pyetësorëve që plotësojnë për vlerësimin e procesit akademik, i cili është një proces që kryhet në mënyrë të pavarur nga secili pedagog në fund të semestrit.</p> <p>Studenti ka të drejtë të japë vlerësimin e vetë në mënyrë të pavarur dhe pa praninë e pedagogut të lëndës në auditor në momentin e vlerësimit.</p> <p>Procedurat e pjesëmarrjes dhe angazhimit të studentëve e</p>

	<p>përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje janë prezente. Nxitet analiza e vazhdueshme e impaktit real të angazhimit studentor në nivele të ndryshme të procesit vendimmarrës në institucion.</p> <p>(Evidenca 1_Statuti i UAMD; Evidenca 44_Formular i vetevlerësimit të performancës; Evidenca 85_Urdhër për ngritjen e grupit te punes RVB)</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Nga feedback-u i marrë ndryshimi i kurrikulave si në DSHP realizohet në mënyrë periodike e të qendrueshme. Megjithatë opinioni i studentëve është reflektuar në përshtatjen e mësimdhënies, orareve, shpërndarjes së provimeve etj. Ndryshimet afatshkurtër në programin e studimit mund të reflektohen për programet e lëndëve. Studentët kanë të drejtën e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit, nëpërmjet vlerësimeve semestrale ose vjetore që organizohen nga njësiti e sigurimit të cilësisë.</p> <p>(Evidenca 7_Rregullore e UAMD)</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ konstatoi se ky informacion ju bëhej me dije studentëve dhe u konfirmua po ashtu edhe gjatë takimit me studentët, të cilët pohuan se kjo e drejtë e tyre ishte plotësuar në rast nevojë. Pyetësorët e studentit dhe mundësia e ankimimit janë si mekanizma të shprehjes së opinionit dhe ushtrimit të së drejtës lidhur me procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve.</p> <p>(Evidenca 7_Rregullore e UAMD)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se ka një harmonizim ndërmjet bazës ligjore e parashikimeve përkatëse në të me procedurat rutinë të përfaqësimit e integritit të zërit studentor në funksion të përmirësimit të cilësisë në aspektin e mësimdhënies, vendimmarrjes, ofertës akademike në tërësi për programin e studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>UAMD ka krijuar strukturën e vet, e cila u siguron studentëve mbështetjen e nevojshme akademike, vë në dispozicion burimet dhe plotëson kërkesat që iu duhen për të pasur sukses në universitet (Sekretaritet, Zyra e IT, Zyra e Financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI). Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Tutorati ndihmon për të orientuar e bashkëpunuar ngushtë me</p>

	<p>studentët. (Evidenca 79_Kalendari i aktiviteteve - Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Drejtoria e Garantimit të Standardeve dhe Cilësisë tërheq përmes pyetësorëve dhe anketimeve mendimet dhe idetë e studentëve lidhur me procesin mësimor e programet e studimit.</p> <p><i>Zyra e Këshillimit dhe Karrierës ofron shërbime këshillimore dhe orientuese në dobi të studentëve por që nuk është plotësisht i plotë, pasi studentët nuk e njihnin mirë rolin e plotë të zyrës.</i></p> <p>Institucioni ka krijuar struktura të posaçme dhe funksionale në shërbim të studentëve, por ka në dispozicion edhe një sistem menaxhimi i cili është në dispozicion të çdo studenti. Në javën e parë të çdo viti akademik departamentet organizojnë informimin e studentëve të vitit të parë mbi çështjet administrative nga zyrat kryesore administrative të Universitetit.</p> <p>(Evidenca 1_Statuti UAMD; Evidenca 8_Rregullore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike 2020)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm. në lidhje me kompletimin e procesit mësimor. zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe takimi me përfaqësues të Sektorit të Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, GVJ u informua se, bazuar në Rregulloren e Sektorit të Komunikimit, Alumnit & Karrierës, si edhe Raportëve vjetore, Sektori i Karrierës dhe Alumnit është struktura përgjegjëse që zhvillon dhe drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron shërbime të ndryshme këshillimi dhe konsultimi për studentët e rinj dhe për ata që diplomohen. Roli i saj konsiston në informimin e studentëve mbi mundësi për aktivizimin e potencialeve të tyre, mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, trajnime, praktika, shkolla verore. Gjithashtu në këtë kuadër ky sektor, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, ëorkshop-e, harton dhe raporton periodikisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të dhënat statistikore. <i>Por, sikurse cituar dhe në kriterin më lart, roli i kësaj zyre nuk është plotësisht i plotë, pasi studentët nuk e njihnin mirë rolin e saj.</i></p> <p>(Evidenca 80_Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet; Evidenca 79_Kalendari i aktiviteteve - Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës)</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Këshillimit dhe Karrierës mban kontakte të vazhdueshme me studentët edhe pas diplomimit duke aktivizuar edhe rrjetin alumni bazuar në Rregulloren e Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës.</p> <p>Sektori i Komunikimit, Alumnit & Karrierës ofron jo vetëm vendosjen e kontakteve me Alumnit e UAMD me qëllim gjurmimin dhe mbledhjen e informacioneve mbi punësimin e tyre duke evidentuar rastet e suksesit si dhe duke i ardhur në ndihmë atyre që janë të papunë për t'i informuar mbi mundësi punësimi dhe praktikash, por edhe ftesën për Alumnit e suksesshëm për të zhvilluar</p>

	<p>orë të hapura leksioni apo seminaresh për studentët ku të tregojnë mbi eksperiencat e tyre profesionale dhe karrierën e tyre të suksesshme; Ish studentët (alumni), që kanë arritur një nivel të lartë profesional, propozohen për “Çmimin e Karrierës”, i cili synon të promovojë arritjet e tyre dhe të shërbejë si shembull për të gjithë ata që do të mbarojnë studimet pranë UAMD siç evidentohet në Raportin e Sektorit të Karrierës dhe Alumnit. GVJ konfirmon që zyra nuk ka mundur të zhvillojë çdo vit vrojtimin me studentët e diplomuar, pasi stafi në dispozicion nuk ishte i mjaftueshëm dhe nuk mund të realizohej një gjurmim i tillë për të gjithë programet. (Evidenca 49_Model Pyetesor per studentet e diplomuar; Evidenca 79.1_Udhëzues - Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës)</p>			
Konkluzione	<p><i>UAMD ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme, por GVJ vëren se këto procedura e njësi nuk janë lehtësisht të arritshme nga studentët dhe prezente e funksionale në institucion.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Njësia kryesore/bazë ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron. Stafi i motivuar në përditësimin dhe aplikimin e metodologjive mësimdhënëse me në qendër studentin. GVJ konstaton se Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës ka krijuar struktura dhe ka miratuar politika të brendshme që sigurojnë cilësinë në mësimdhënie në përmbushje të kërkesave të ligjit, të cilat kanë objektiv zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe të të nxënit si dhe promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme në mbështetje të Rregullores së NJBSC.</p> <p>(Evidenca 1_Statuti; Evidenca 7_Rregullore e UAMD; Evidenca</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Email: info@ascal.al

	<p>10_Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë; Evidenca 11_Urdher per ngritjen e njesise se brendshem te sigurimit te cilesise; Evidenca 16_Struktura Organizative e UAMD)</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimi i mësimdhënies në auditor, kryesisht për anëtarët e personelit akademik të kategorisë lektorë dhe asistentë lektorë, nga Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit. Të gjithë lektorët e DSHP nënshkruajnë në fillim të vitit akademik një marrëveshje me Përgjegjësen e Departamentit dhe ata janë përgjegjës për zbatimin e saj. Përgjegjësja e departamentit dhe Dekani vlerësojnë në mënyrë të strukturuar performancën e lektorëve gjatë vitit akademik në fund të secilit vit akademik. - pyetësorët vlerësues të stafit akademik. <p>Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese që ndjek përmirësimin e cilësisë në UAMD. (Evidenca 10_Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë; Evidenca 45_Formular vlerësimi nga studentët per pedagoget)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Institucioni ka politikë të qartë dhe përdor disa instrumenta për sigurimin e cilësisë si: formularë, pyetësorë, raporte vlerësimi dhe vetëvlerësimi pedagogët.</p> <p>GVJ u informua nepermjet takimeve me pedagoget si edhe me studentet se UAMD organizon një anketim të përvitshëm për të matur vlerësimin e studentëve për performancën e lektorëve. Formulari i Anketimit hartohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe miratohet nga Rektorati. Procesi i Anketimit zhvillohet në mënyrë periodike dhe organizohet nga Drejtoria e Informacionit të Teknologjisë dhe e Regjistrimeve e cila brenda 15 ditëve dërgon rezultatet e anketimit tek Njësia e Sigurimit të Cilësisë. Kjo e fundit brenda 10 ditëve harton raportin e vlerësimit përfundimtar të anketimit dhe e përcjell atë në Rektorat. Nga ana tjetër, studentët kanë të drejtë të shprehin ankesat dhe sugjerimet e tyre në mbledhjet e hapura të departamentit, pranë Përgjegjësit të departamentit, Dekanit dhe autoriteteve të tjera drejtuese. Sa i përket ankesave individuale për vlerësimin e marrë në kuadër të lëndëve të zhvilluara, studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin. Dekani, brenda 48 orësh nga marrja dijeni për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. Ndryshimet</p>




	<p>në rezultatet e studentëve në procesverbalin e firmosur dhe në sistemin online bëhen me komisione të posaçme. (Evidenca 10_Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë; Evidenca 87_Tabela per vleresimin e stafit)</p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit të pyetësorit të kryer për çdo semestër akademik, te cilat i vihen në dispozicion strukturave vendimmarrëse të fakultetit, si dhe në mënyrë individuale të gjithë anëtarëve të Stafit Akademik, të vlerësuar. (Evidenca 10_Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nxitet vijnësia e procesit të promovimit të shembujve e praktikave të mira. Stafi akademik për programin e studimit është i përkushtuar drejt përmirësimit të mëtejshëm, me qasje proaktive e përfshirëse me studentët. GVJ doli në përfundimin se krahas procedurave të akreditimit për të siguruar cilësinë e programve UAMD vlerëson edhe performancën e programeve të studimit mbështetur në treguesit e cilësisë për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, rishikon dhe përmirëson ato duke marr në konsideratë nevojat e tregut të punës, opinionet e marra nga studentët dhe alumni, vlerëson mësimdhënien dhe rezultatet e të nxënit. (Evidenca 10_Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies në UAMD sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit dhe vlerësimit të përgjegjës të departamentit dhe dekani. Rezultatet dhe analizat e pyetësorëve i vihen në dispozicion individualisht të gjithë anëtarëve të stafit akademik, përgjegjësve të departamenteve, si dhe dekanëve duke diskutuar njëkohësisht edhe problematikat ekzistuese të mundshme dhe planin e masave për përmirësimin e tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------




Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, GVJ konstaton se UAMD, në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, ka të ngritura dhe funksionale struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë.

Bazuar në rregulloren për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë (**Evidenca 10**), në nivel institucional strukturat përgjegjëse për sigurimin e standardeve të cilësisë janë:

- Senati Akademik;
- Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë;
- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;
- Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë.

Në nivel fakulteti, përgjegjës për sigurimin e standardeve të cilësisë janë:

- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve;
- Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program studimi;
- Koordinatorët e programeve.

Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPGSC) është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision kërkon në mënyrë të vazhdueshme informacione dhe raporte lidhur me çështjet e cilësisë dhe programeve të studimit nga NjSBC, e cila ka si funksion kryesor bashkëpunimin dhe asistimin e këtij Komisioni. Komisioni mbikëqyr dhe pranon raportet 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga NjSBC dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm.

Misioni kryesor i NjBSC është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm të UAMD dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim. Procesi i përmirësimit të vazhdueshëm mundësohet nga angazhimi i të gjitha palëve të përfshira në sistemin e sigurimit të brendshëm. Në UAMD, rolin e NjBSC-së e realizon Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë.

NjBSC në nivel Fakulteti realizon në mënyrë autonome objektivat dhe masat e vendosura nga NjBSC në nivel Institucional. Në realizimin e këtyre objektivave NjBSC në nivel Fakulteti kërkon dosjen e programeve të studimit nga koordinatoret e programeve. Në realizimin e objektivave të akreditimit NjBSC në nivel Fakulteti bashkëpunon me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për programet e studimit, duke u koordinuar nga NjBSC në nivel Institucional. Dokumentacioni i NjBSC në nivel Fakulteti i përcillet Dekanit dhe NjBSC në nivel Institucional.

GVJ mendon se struktura ishte e organizuar me nje personel shumë të

	<p><i>limituar në staf dhe sugjeron UAMD të mbajë në konsideratë mundësinë e shtimit të personelit të NjBSC.</i></p> <p>(Evidenca 1_Statuti i UAMD; Evidenca 10_Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë; Evidenca 11_Urdher per ngritjen e njesise se brendshem te sigurimit te cilesise; Evidenca 16_Struktura Organizative e UAMD)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision përbëhet nga përfaqësues nga secila njësi kryesore e UAMD dhe një përfaqësues të studentëve.</p> <p>Në nivel institucioni funksionon gjithashtu Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e ngritur me Urdhër të Rektorit, e cilë përbëhet nga një përfaqësues nga stafi akademik i çdo fakulteti të UAMD, drejtuesi i Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë në Rektorat, si dhe një përfaqësues nga studentët. Kjo njësi realizon raporte periodike të vetëvlerësimit në bashkëveprim me Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel fakulteti.</p> <p>GVJ konstaton se Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në nivel institucional NjSBC në nivel Fakulteti si dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë ushtrojnë kompetencat me funksione të plota në ruajtjen e standardeve dhe sigurimin e cilësisë të Institucionit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion drejtuesit e programit dhe stafi akademik konfirmojnë së rishikimet e programit të studimit (nevoja të ndryshme për shtimin apo heqjen e lëndëve, përfshirjen e disiplinave të reja, ndryshimi i kategorizimit të disiplinave, apo ndryshime në ECTS dhe ngarkesën e orëve) janë realizuar konform kuadrin ligjor në fuqi me propozime të cilat vijnë nga departamenti dhe me miratim nga senati deri në masën 20 % të programit.</p> <p>(Evidenca 1_Statuti i UAMD; Evidenca 7_Rregullore e UAMD 2018; Evidenca 10_Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL.</p> <p>UAMD i është nënshtruar në vitin 2016 procesit të akreditimit institucional dhe u vlerësua me një akreditim pozitiv me kohëzgjatje 4 vite akademike. Gjithashtu, sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 18, datë 24.03.2022 "Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti Aleksandër Moisiu", Durrës", është vendosur akreditimi periodik institucional, me vlerësim përfundimtar</p>

	<p>pozitiv, me kohëzgjatjen prej 4 vite akademike dhe afat përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit deri më 23/03/2026.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie me Publikun” është hapur me UMASH Nr. 371, datë 05.09.2013. Ky program studimi është riorganizuar për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për arsimin e lartë, përshtatjen e programit Bachelor në “Marrëdhënie me Publikun”, me Vendim Senati Nr. 114, datë 14.06.2018, miratuar nga MASR me shkresën me Nr. 7649/1 Prot., datë 18.09.2018. Gjithashtu, programi është riorganizuar me UMAS nr. 335, datë 04.07.2023 në Bachelor në “Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun”. Ky është procesi i parë i akreditimit që ky program studimi po i nënshtrohet për ata studentë që janë regjistruar në këtë program studimi dhe ndjekin ende studimet në këtë program studimi, deri në diplomimin e tyre.</p> <p>(VBA Nr. 10, datë 07.04.2017; VBA Nr. 18, datë 24.03.2022; Vendim Senati Nr. 114, datë 14.07.2018; Shkresë MAS Nr. 7649/1 Prot., datë 18.09.2018; UMAS nr. 335, datë 04.07.2023; Evidenca 10_Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë (Evidenca 10), Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ka në kompetencat e tij kontrollin dhe miratimin e raporteve 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm. GVJ, nga dokumentacioni i paraqitur dhe diskutimet me stafin akademik dhe administrativ, konstaton se raportet e deritanishme janë të fokusuar në pasqyrimin e arritjeve dhe të dobësive të programit specifik.</p> <p>Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies kryhet për të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme. Ruajtja e nivelit të regjistrimeve, nivelet e kalueshmërisë, nivelet e diplomimit, diversiteti i profileve studentore, ndërkombëtarizimi etj. Këto të dhëna mblidhen në nivel fakulteti dhe i dërgohen NjBSC-së, çdo fillim viti akademik. Më tej ajo ka për detyrë të japë mendim në formën e sugjerimeve dhe masave korrigjuese. Të dhënat, sugjerimet dhe masat korrigjuese shqyrtohen nga KPGSC-ja, dhe më pas i propozohen Senatit Akademik për miratim.</p> <p>(Evidenca 1_Statuti i UAMD; Evidenca 7_Rregullore e UAMD 2018; Evidenca 10_Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë; Evidenca 87_Tabela për vlerësimin e stafit)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD ka të ngritura struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucioni dhe njësie kryesore, të cilat zhvillojnë veprimtarinë e tyre bazuar në aktet e brendshme rregullatore të institucionit. UAMD ka të hartuara dhe zbaton politika e procedura</i></p>




	<i>transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Mekanizmat përgjegjës të identifikuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimi i studentëve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies së pedagogëve dhe të efikasitetit të programeve të studimeve; - raportet e vetëvlerësimit; - vlerësimi i drejtuesit të njësisë kryesore. <p>GVJ konstaton se FSHPJ bashkëpunon me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë në përputhje me politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë me qëllim mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit.</p> <p>Bazuar në Ligjin e Arsimit të lartë, Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore, në varësi të llojit të institucion. Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukurore të tij, sipas standardeve të cilësisë. Departamenti menaxhon fondet bazë të kërkimit shkencor apo fonde të tjera që gjenerohen nga burime të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare ose ndërkombëtare.</p> <p>Programet e studimit në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike i janë nënshtuar riorganizimit në vitin akademik 2021-2022, kjo për arsye të pajisë studentët me njohuri e shprehi te avancuara dhe me kompetenca të gjëra që kërkohen për t'u punësuar në përputhje me nevojat e tregut të diversifikuar të punës, synon që të ofrojë një program studimi bazuar në kurrikul më bashkohore.</p>
	<p>(Evidenca 1_Statuti i UAMD; Evidenca 7_Rregullore e UAMD 2018; Evidenca 10_Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë)</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme,</p>	<p>Raportet e analiza e ecurisë së programit të studimit me synim</p>

<p>rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim duhet të jetë periodike dhe e vazhdueshme. Institucioni ka kapacitet për të realizuar matje sasiore e cilësore për të përmbushur sa më sipër.</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatoi që instrumenti i përdorur është i mjaftueshëm për të siguruar një vlerësim sa më holistik dhe të besueshëm në përputhje dhe me specifikën e fushës akademike të programit të studimit, si dhe të mundësohet përdorimi periodikisht i tyre.</p> <p>(Evidenca 1_Statuti i UAMD; Evidenca 7_Rregullore e UAMD 2018; Evidenca 10_Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UAMD përdor matës të tillë si: cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje (nota mesatare), kalueshmëria e kurseve, përqindja e studentëve të diplomuar brenda kohëzgjatjes normale të programit, përqindja e punësimit të studentëve brenda profilit pas diplomimit.</p> <p>GVJ u informua gjatë takimit me pedagogët, Drejtuesin e DSHP, si edhe studentët se në kuadër të përmirësimit të cilësisë përdoren metoda të drejtpërdrejta, duke iu referuar rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe manualit për sistemin e brendshëm për sigurimin e cilësisë në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike. Këto metoda të drejtpërdrejta përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, ku bën pjesë dhe ky program i studimit; - vlerësimin e didaktikës, kurrikulës, leksioneve, syllabuseve, literaturat e përdorura; - të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve; - procesi i tutoriatit/mentorimit (referuar Aneksit 135, vendim i mentorimeve dhe grafiku). <p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe takimet në IAL konstatoi që departamenti përdor instrumenta të tërthortë vlerësimi, duke mundësuar kështu një vlerësim të plotë të realizimit të objektivave të programit dhe duke mos mundësuar mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>(Evidenca 1_Statuti i UAMD; Evidenca 7_Rregullore e UAMD 2018; Evidenca 10_Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë; Evidenca 46_Raporti i vlerësimit të brendshëm në FSHPJ; Evidenca 47_Analiza e Departamentit të Shkencave Politike 2021-2022; Evidenca 48_Analiza Vjetore e Departamentit të Shkencave Politike, 2018-2019)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes</p>	<p>Në përmirësimin e cilësisë luan rol të rëndësishëm edhe përfshirja e studentëve dhe palëve të treta. Instrumentat e përdorura për metodën e</p>

<p>e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>tërthortë (sondazhe, intervista) janë pasqyruar në nenet 6 dhe 15 të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, mbështetur nga njësitë kryesore në IAL, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimi si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - organizon pyetësorë drejtuar studentëve dhe ALUMNI për të marrë mendim në lidhje me cilësinë e programit të studimit; - organizon pyetësorë në formë elektronike drejtuar kompanive/palëve të treta për të analizuar performancën dhe përgatitjen e njohurive që kanë studentët e diplomuar; - organizon ëorkshop-ve/panaire pune ku mbledh sugjerimet dhe kërkesat e bizneseve në lidhje me programet e studimeve . <p>Evidenca 10_Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë; Evidenca 44_Formular i vetevlerësimit te performances; Evidenca 45_Formular vlerësimi nga studentët per pedagoget; Evidenca 49_Model Pyetesor per studentet e diplomuar; Evidenca 50_Të dhëna ALUMNI për punësimin e studentëve të UAMD)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. GVJ evidenton nevojën për të adresuar në përputhje me kapacitetet ekzistuese që programi tashmë zotëron, palët e treta, si dhe analizën e përditësuar e sistematike të ecurisë së punës në programin e studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri I. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Strukturat e ngritura në UAMD dhe procedurat e zbatuara janë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Në UAMD funksionon sistemi i vlerësimit të brendshëm ku përfshihen aktorë në nivel Institucional (Senati Akademik, Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Koordinatori Institucional pranë ASCAL, Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë), në nivel Fakulteti (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program,</p>

	<p>Koordinatorët e Programeve) dhe studentët.</p> <p>KPSSC dhe NJSBC si strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë mbështeten nga eksperti i jashtëm në përbushjen e detyrave dhe bazohen në respektimin e procedurave të sanksionuara në Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>(Evidenca 1_Statuti i UAMD; Evidenca 7_Rregullore e UAMD 2018; Evidenca 10_Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Bazuar në strukturat e ngritura për Sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, UAMD nëpërmjet Rregulloreve të posaçme për këtë qëllim ka përcaktuar përgjegjësitë e detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Përfshirja e personelit akademik dhe studentëve në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në takime dhe komisione si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, nëpërmjet ngritjes së grupit të punës së vlerësimit të brendshëm.</p> <p>(Evidenca 1_Statuti i UAMD; Evidenca 7_Rregullore e UAMD, Evidenca 8_Rregullore e FSHPJ; Evidenca 10_Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë)</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përfshihen studentët, pedagogët, strukturat në nivel fakulteti, departamenti dhe në rang universiteti.</p> <p>GVJ konstaton se në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përfshihen studentët, pedagogët, strukturat në nivel fakulteti, departamenti dhe në rang universiteti. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohet përfshirja e departamenteve dhe FSHPJ, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>(Evidenca 1_Statuti i UAMD; Evidenca 7_Rregullore e UAMD, Evidenca 8_Rregullore e FSHPJ; Evidenca 10_Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë)</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Rregullorja e UAMD, Rregullorja e FSHPJ dhe Rregullorja e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë garantojnë integritetin akademik dhe shmangien e diskriminimit apo pabarazitë kundrejt personelit dhe studentëve. Ato garantojnë një pjesëmarrje të drejtë të personelit akademik, ndihmës akademik e të studentëve në këtë proces. Përzgjedhja e personelit për këtë proces bazohet në kontributin, seriozitetin dhe integritetin akademik. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton</p>

	integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. (Evidenca 1_Statuti i UAMD; Evidenca 7_Rregullore e UAMD, Evidenca 8_Rregullore e FSHPJ; Evidenca 10_Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë)			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Institucioni dëshmon angazhimin edhe të aktorëve të jashtëm në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit. GVJ konstaton se po përfshihen në procesin e vlerësimit, sigurimit të brendshëm të cilësisë, e përmirësimin e saj, edhe përfaqësuesit e institucioneve dhe aktorë të tjerë. Në Sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe proceset e vlerësimit, bazuar në rregullat e përcaktuara të funksionimit të këtij sistemi përfshihen edhe bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm, të cilët kanë dhënë mendime dhe ekspertizën e tyre në lidhje me cilësinë dhe dhe përmirësimet e mundshme të tij. (Evidenca 1_Statuti i UAMD; Evidenca 7_Rregullore e UAMD, Evidenca 8_Rregullore e FSHPJ; Evidenca 10_Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë)			
Konkluzione	<i>Institucioni përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Nga takimet e drejtpërdrejta me studentët, GVJ konstatoi se për studentët realizohet java informuese, ku ata informohen nga lektorët e departamentit në lidhje me funksionimin dhe organizimin e çdo programi studimi. Pranë UAMD prej vitesh realizohet raportimi vjetor nga ana e rektoratit lidhur me realizimin e objektivave të parashtruara. Në të njëjtin format edhe pranë fakulteteve dhe departamenteve realizohet në mënyrë periodike informim dhe mendimarrje nga strukturat e ndryshme me kolegët lektorë, stafin administrativ dhe studentët. Nëpërmjet ëeb-it të UAMD, komunikimeve më email, takimeve informuese dhe publikimeve në rrjetet sociale studentët informohen periudikisht për organizimin, strategjitë, politikat, veprimtaritë dhe

	<p>masat e marra për ecurinë dhe përmirësimin e cilësisë. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> <p>(Evidenca 1_Statuti i UAMD; Evidenca 7_Rregullore e UAMD, Evidenca 8_Rregullore e FSHPJ; Evidenca 10_Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë; Evidenca 46_Raporti i vleresimit te brendshem ne FSHPJ)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të programeve të studimit iu vihen në dispozicion personelit akademik, dhe publikohen për studentët dhe aktorët e tjerë.</p> <p>GVJ konstaton se është përgatitur programi i transparencës i cili konsiston në përcaktimin e rregullave bazë të organizimit dhe të funksionimit të universitetit në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë. Programi i transparencës në UAMD i shërben rritjes së transparencës, integritetit dhe përgjegjshmërisë institucionale të universitetit sipas objektit dhe qëllimit të këtij ligji duke pasur parasysh interesin më të mirë të publikut. Publikimi i informacionit përmes këtij programi ka si qëllim t'i shërbejë transparencës të organizimit dhe funksionimit si dhe të misionit dhe veprimtarisë së UAMD-së dhe realizohet përmes publikimit të detajuar të këtij informacioni në faqen zyrtare të internetit www.uamd.edu.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut.</p> <p>(Evidenca 1_Statuti i UAMD; Evidenca 7_Rregullore e UAMD, Evidenca 8_Rregullore e FSHPJ; Evidenca 10_Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë; Evidenca 46_Raporti i vleresimit te brendshem ne FSHPJ; Evidenca 47_Analiza e Departamentit te Shkencave Politike 2021-2022)</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit shoqërohen me reflektim konkret për të adresuar përmirësimin e mangësive e dobësive. Vlerësimet dhe analizat e realizuara identifikojnë nevojat për përmirësime të metejshme. <i>Stafi i Fakultetit të Shkencave Politike Juridike duhet të marrë masa në mënyrë të vazhdueshme për përmirësime të mëtejshme. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</i></p> <p>(Evidenca 1_Statuti i UAMD; Evidenca 10_Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë; Evidenca 46_Raporti i vleresimit te brendshem ne FSHPJ; Evidenca 46_Raporti i vleresimit te brendshem ne FSHPJ; Evidenca 47_Analiza e Departamentit te Shkencave Politike 2021-2022)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe</p>	<p>NJSBC analizon në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarisë</p>

<p>siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>mësimore dhe ato të kërkimit shkencor. Kjo realizohet përmes bashëpunimit me Departamentet, Fakultetet dhe Njësitë ndihmës akademike në nivel universiteti. Produkt i kësaj analize periodike janë raportet vjetore që hartohen në nivel departamenti dhe raporti vjetor i IAL që dorëzohet në MASR. Raportet diskutohen në strukturat vendimarrëse përpara se të publikohen dhe miratohen prej tyre.</p> <p>(Evidenca 48_Analiza Vjetore e Departamentit të Shkencave Politike, 2018-2019; Evidenca 40_Buletini i aktiviteteve dhe kerkimit shkencor FSHPJ, dhjetor 2022; Evidenca 41_Kerkimi shkencor permbledhese, DSHP 2021-2022; Evidenca 41.1_Tabela permbledhese e kerkimit shkencor FSHPJ; Evidenca 41.2_Raport mbi aktivitetin kerkimor shkencor permbledhese, FSHPJ 2021-2022)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti dhe departamenti organizojnë takime informuese për ndryshimet e ndodhura dhe përmirësimet e mëtejshme. Njëkohësisht, personeli është në dispozicion në ditë dhe në orare të ndryshme për studentët. Nga takimet me stafin akademik të DSHP, GVJ konstaton se NJSBC organizon takime me strukturat e rektoratit dhe të fakulteteve për të rritur efektivitetin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e të vlerësimit të cilësisë. Ndër veprimtaritë kryesore që institucioni ka ndërmarë në lidhje me ndërgjegjësimin dhe informimin e studentëve dhe personelit kanë qenë: informimi i stafit për proceset e vlerësimit; informimi i studentëve mbi rëndësinë e vlerësimit të kurrikulës/pedagogut për përmirësimin e programit të studimit; përfshirja e studentëve në plotësimin e pyetësorëve për vlerësimin e performancës.</p> <p>(Evidenca 1_Statuti i UAMD; Evidenca 10_Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit janë publike, transparente dhe efektive dhe synojnë krijimin e kulturës së brendshme të cilësisë. Stafi i Fakultetit të Shkencave Politike Juridike duhet të marrë masa në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimet e mëtejshme. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Marrëdhënie me Publikun”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Pika të forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit u referohet përvojave cilësore të universiteteve europiane botërore dhe është i strukturuar në mënyrë që të përkujdeset për studentët deri në nivelet më të larta të kualifikimit.
2. Staf i akademik efektiv dhe ai me kontratë në Departamentin e Shkencave Politike vjen nga eksperiencia në vende të ndryshme. Formimi dhe eksperiencia akademike brenda dhe jashtë vendit, mosha relativisht e re, niveli i kualifikimit në rritje, vërtetuar me gradat e titujt e fituar, garantojnë transmetimin efektiv të dijeve.
3. Staf i akademik shkëmben vazhdimisht eksperiencia në mësimdhënie e në kërkim shkencor në universitete ndërkombëtare.
4. Administrimi online i të dhënave nga njësitë kryesore rrit cilësinë e shërbimeve ndaj studentëve, si dhe transparencën ndaj tyre dhe stafit.
5. UAMD zotëron një kampus universitar të pajisur me të gjitha kushtet e nevojshme për të zhvilluar një proces mësimor sa më bashkëkohor dhe frytdhënës.
6. Rezultatet e anketimeve të zhvilluara me stafin akademik dhe administrativ tregojnë për një marrëdhënie të qëndrueshme me Institucionin, e bazuar në korrektesën e dyanshme.
7. Bazuar në kontrollin e njohurive teorike dhe praktike, organizimi i provimeve të ndërmjetme e përfundimtare, ballafaqimi i vlerësimit në çdo rast, përdorimi i sistemeve të informatizuara (Pitagora) për publikimin e vlerësimeve dhe kontrollin e tyre të automatizuar (Cleanscore) dëshmojnë transparencën e Institucionit në kontrollin e dijeve.

Pika të dobëta:

1. Mungesa e literaturës në gjuhën shqipe, të përshtatshme për nevojat e programit të studimit, në syllabuset e disa prej lëndëve të programit si dhe në kopje fizike në bibliotekën e Institucionit. **(Standardi II.4, kriteri 5; Standardi IV.3, kriteri 1; Standardi IV.3, kriteri 4)**
2. Mungesa e një studimi të mirëfilltë të tregut të punës të fokusuar për studentët që mbarojnë këtë profil, duke qënë se fusha dhe tregu i mundshëm i punës së të diplomuarve të këtij programi është i larmishëm. **(Standardi II.4, kriteri 7; Standardi V.4, kriteri 5)**
3. Procedurat dhe njësitë e posaçme të ngritura nga institucioni për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme, nuk janë lehtësisht të arritshme nga studentët dhe prezente e funksionale në institucion. **(Standardi V.6, kriteri 2 dhe 3; Standardi V.6, kriteri 4)**
4. Analiza e ecurisë së programit të studimit dhe raportet nuk realizohen në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme, si dhe rezultatet e vlerësimit nuk shoqërohen me një

plan masash që të adresojë dhe synojë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. (Standardi VI.3, kriteri 2; Standardi VI.5, kriteri 3)

Rekomandime:

1. Institucioni, të shohë me prioritet shtimin e literaturës në gjuhën shqipe në syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi dhe numrin e titujve specifik të fushës së marrëdhënieve me publikun në bibliotekën e universitetit. (Standardi II.4, kriteri 5; Standardi IV.3, kriteri 1; Standardi IV.3, kriteri 4)
2. Institucioni, të testojë e studiojë më në gjerësi tregun e punës dhe mundësitë e drejtpërdrejta të punësimit pas diplomimit, për profilin e këtij programi studimi, dhe të adresojë treguesit e studimit siç duhet për studentët e rinj në këtë program. (Standardi II.4, kriteri 7; Standardi V.4, kriteri 5)
3. Institucioni, të ndërmarrë masa e aktivitete mbi promovimin dhe rolin e njësive të posaçme të ngritura për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, në mënyrë që ato të jenë prezente e aktive në institucion dhe lehtësisht të aksesueshme nga studentët. (Standardi V.6, kriteri 2 dhe 3; Standardi V.6, kriteri 4)
4. Institucioni, të marrë masa në mënyrë të vazhdueshme për përmirësime të mëtejshme të programit të studimit dhe rezultatet e vlerësimit të shoqërohen me plan masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. (Standardi VI.3, kriteri 2; Standardi VI.5, kriteri 3)
5. Departamenti, të identifikojë dhe iniciojë kontraktimin institucional me qendrat e praktikave, biznese apo institucione, duke hartuar një listë të veçantë me institucionet ku mund të kryhet praktika, që të garantohet ambjent pune, ekspertizë nga institucioni ku bëhet praktika, vlerësimin e përkushtimin dhe individë apo struktura ndjekëse të tëtij komponenti të programit. Gjithashtu, rekomandohet prirja drejt forcimit të bashkëpunimit mes IAL dhe institucioneve që ofrojnë vendet e punës që janë nën tipologjinë e diplomës përkatëse, e cila do të ndikonte pozitivisht në forcimin e programit të studimit dhe nxjerrjen e brezave të kualifikuar në këtë drejtim. (Standardi I.2, kriteri 3; Standardi IV.1, kriteri 7)

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in "Public Relations", provided by the Higher Education Institution "Aleksandër Moisiu" University, Durrës

Strengths and affirmations:

1. The study program refers to the quality experiences of global European universities and is structured to cater to students up to the highest levels of qualification.
2. Effective academic staff and staff with contracts in the Department of Political Sciences come from experience in various countries. Training and academic experience both within and outside the country, relatively young age, increasing


- qualification level, evidenced by degrees and titles obtained, guarantee the effective transmission of knowledge.
3. The academic staff continuously exchanges teaching and research experiences at international universities.
 4. Online management of data by key units enhances the quality of services to students, as well as transparency towards them and the staff.
 5. UAMD possesses a university campus equipped with all necessary conditions to develop a contemporary and fruitful teaching process.
 6. Results of surveys conducted with academic and administrative staff indicate a sustainable relationship with the Institution, based on mutual correctness.
 7. Based on the control of theoretical and practical knowledge, the organization of interim and final exams, confronting assessment in every case, using computerized systems (Pitagora) for the publication of assessments and their automated control (Cleanscore) demonstrate the transparency of the Institution in knowledge control.

Weaknesses:

1. The lack of literature in Albanian, suitable for the needs of the study program, in the syllabi of some of the subjects of the program as well as in physical copies in the Institution's library. **(Standard II.4, criterion 5; Standard IV.3, criterion 1; Standardi IV.3, criterion 4)**
2. The absence of a comprehensive study of the job market focused on students graduating from this profile, given that the field and potential job market for graduates of this program are diverse. **(Standard II.4, criterion 7; Standard V.4, criterion 5)**
3. The procedures and special units established by the institution for welcoming, orienting, advising students, managing complaints and issues, which operate continuously, are not easily accessible to students and are not functionally present in the institution. **(Standard V.6, criterion 2 and 3; Standard V.6, criterion 4)**
4. Analysis of the progress of the study program and reports are not carried out periodically and continuously, and the evaluation results are not accompanied by a plan of actions to address and aim to improve the identified deficiencies and weaknesses. **(Standard VI.3, criterion 2; Standard VI.5, criterion 3).**

Recommendations:

1. The institution should prioritize the addition of literature in Albanian to the syllabi of the subjects in this study program and increase the number of specific titles in the field of public relations in the university library. **(Standard II.4, criterion 5; Standard IV.3, criterion 1; Standard IV.3, criterion 4)**
2. The institution should thoroughly test and study the job market and direct employment opportunities after graduation for the profile of this study program, and address the study indicators appropriately for new students in this program. **(Standard II.4, criterion 7; Standard V.4, criterion 5)**
3. The institution should take measures and activities to promote and enhance the role of special units established for welcoming, orienting, advising students, managing



- complaints and issues, so that they are present and active in the institution and easily accessible to students. **(Standard V.6, criterion 2 and 3; Standard V.6, criterion 4)**
4. The institution should take continuous measures for further improvements of the study program, and evaluation results should be accompanied by action plans addressing and aiming to improve identified deficiencies and weaknesses. **(Standard VI.3, criterion 2; Standard VI.5, criterion 3)**
 5. The department should identify and initiate institutional contracts with internship centers, businesses, or institutions, drafting a specific list of institutions where internships can be conducted to ensure a work environment, expertise from the institution where the internship takes place, evaluation commitment, and individuals or follow-up structures of this component of the program. Additionally, there is a recommendation for strengthening cooperation between the institution and entities offering jobs relevant to the diploma, which would positively impact the strengthening of the study program and the production of qualified generations in this field. **(Standard I.2, criterion 3; Standard IV.1, criterion 7)**



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X